

INVESTITORI
“2T COMPANY” SH.P.K.

Caravodicë, Komuna Obiliq



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR QENDRËN E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE
METALIKE DHE MBETURINAVE TJERA SIPAS KATALOGUT SHTETËROR TË MBETURINAVE, NGA
KOMPANIA “2T COMPANY” SH.P.K., CARAVODICË, KOMUNA E OBILIQIT

Obiliq, Shkurt 2026

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR QENDRËN E
GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE METALIKE DHE MBETURINAVE TJERA
SIPAS KATALOGUT SHTETËROR TË MBETURINAVE, NGA KOMPANIA
“2T COMPANY” SH.P.K.

Ngastrat me nr. P-72614072-00486-1, Zona kadastrale Caravodicë, Komuna e Obiliqit

	Emri i Investitorit
Aplikuesi	Edonis Xhota
Investitori	“2T COMPANY” SH.P.K.
Adresa:	Minierat, P.N, Caravodicë, komuna e Obiliqit
Lokacioni i Fabrikës	Caravodicë, komuna e Obiliqit
Tel:	+383 49 337 543
Email:	donxhota@gmail.com

Investitori:

“2T COMPANY” SH.P.K.

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com

+383 49 588 634

Obiliq, Shkurt 2026

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE.....	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	2
3.	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.....	3
3.1.	Kategoria e Projektit të Propozuar	4
3.2.	Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit.....	4
3.3.	Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit	4
3.4.	Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit	5
3.5.	Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme	8
3.6.	Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik.....	9
3.7.	Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave	11
3.8.	Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit.....	11
3.9.	Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme	12
3.10.	Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave.....	12
3.11.	Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin	13
3.12.	Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese	13
4.	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR.....	15
4.1.	Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti	15
4.2.	Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit	15
4.3.	Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti.....	17
4.4.	Paraqitje e karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit	18
4.5.	Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë	19
4.6.	Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik	20
4.7.	Karakteristikat natyrore.....	20
4.8.	Karakteristikat themelore të peizazhit.....	21
4.9.	Objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike	22
4.10.	Të dhënat për popullsinë dhe karakteristikat demografike	22
4.11.	Në Zonat me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore në hapësirën e projektit	23
5.	GJENDJAAKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR.....	24
5.1.	Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor	24
6.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT	25

6.1.	Përshkrimi i alternativave të realizueshme	25
6.2.	Arsyet kryesore për zgjedhjen e alternativës së propozuar.....	25
6.3.	Vendndodhja ose rruga.....	25
6.4.	Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut.....	25
6.5.	Proceset dhe teknologjia e prodhimit.....	26
6.6.	Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit	26
6.7.	Plani i lokacionit	26
6.8.	Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit	26
6.9.	Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjisllacionit.....	26
6.10.	Madhësia e lokacionit ose objektit.....	27
6.11.	Vëllimi i prodhimit.....	27
6.12.	Kontrolli i ndotjes	27
6.13.	Trajtimin e mbeturinave	27
6.14.	Infrastruktura rrugore dhe qasja	27
6.15.	Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit	27
6.16.	Trajnimi	28
6.17.	Monitorimi	28
6.18.	Planet për situata emergjente	28
6.19.	Demolimi dhe rehabilitimi	28
6.20.	Plani për menaxhimin e mjedisit.....	28
6.21.	Përshkrimi i alternativës pa veprim	28
7.	PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS	29
7.1.	Ndikimet në ajër.....	29
7.2.	Ndikimet në tokë	30
7.3.	Ndikimet në ujë	30
7.4.	Ndikimi në pejzazh	31
7.5.	Ndikimi në florë dhe faunë	32
7.6.	Ndikimi në nivelet e zhurmës	32
7.7.	Ndikimi social gjatë fazë së ndërtimit, operimit dhe demolimit.....	32
7.8.	Ndikimi nga Mbeturinat.....	33
8.	PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS.....	34
8.1.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	34
8.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	35
8.3.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	35
8.4.	Masat për mbrojtje nga zhurma	36
8.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në pejzazh	37
8.6.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në florë dhe faunë	37
9.	PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS	38
9.1.	Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis.....	38
9.2.	Gjendja mjedisore para fillimit të projektit.....	38

9.3.	Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis ...	39
9.4.	Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar	40
9.5.	Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera	40
9.6.	Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera	40
9.7.	Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis	40
10.	PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR.....	41
11.1.	Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit	41
11.2.	Pajtushmeria me pëlqim mjedisor.....	42
11.3.	Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000	42
12.	INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT	43
12.1.	Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,	43
13.	BURIMET E TË DHËNAVE.....	44
13.1.	Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së	44

Lista e Figurave

Figura 1.	Peshorja	5
Figura 2.	Pranimi i Mbeturinave	6
Figura 3.	Seleksionimi i Mbeturinave.....	6
Figura 4.	Coptimi i Mbeturinave	7
Figura 5.	Produkti final	7
Figura 6.	Distanca me biznese tjera	14
Figura 7.	Shtirja hapësinore e Lokacionit të projektit që do të ndërtohet në territorin e Komunës së Obiliqit.....	16
Figura 8.	Distanca e kompanisë me qytetin e Obiliqit	17
Figura 9.	Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi	17
Figura 10.	Distanca ndërmjet kompanisë dhe shtëpive të pronarëve	18
Figura 11.	Distanca e projektit nga lumi Sitnica	19
Figura 12.	Gropa septike dhe ndarësi i vajrave	31

Lista e Tabelave:

Tabela 1.	Kodet e mbeturinave për aplikim	3
-----------	---------------------------------------	---

1. HYRJE

Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për funksionimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, nga kompania “2T COMPANY” SH.P.K., në Caravodicë, Komuna e Obiliqit, paraqet kërkesë që buron nga Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, me qëllim të sigurimit të zhvillimit të veprimtarisë në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standardet kombëtare dhe evropiane për menaxhimin e mbeturinave. Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përgatitur për të vlerësuar ndikimet e mundshme mjedisore që mund të paraqiten gjatë fazës së operimit të objektit ekzistues për grumbullimin, ruajtjen e përkohshme dhe trajtimin fillestar të mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera të parrezikshme, të cilat pranojnë në përputhje me Katalogun Shtetëror të Mbeturinave dhe kërkesat ligjore në fuqi. Përmes këtij raporti të VNM-së identifikohen dhe analizohen ndikimet e mundshme në mjedis që rrjedhin nga funksionimi i Qendrës së Grumbullimit, duke marrë parasysh karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese mjedisore, mjedisin jetësor përreth, si dhe proceset e punës që zhvillohen në kuadër të aktivitetit të kompanisë. Raporti trajton ndikimet potenciale në ajër, tokë dhe ujë, si dhe përcakton masat parandaluese dhe mbrojtëse që do të zbatohen gjatë operimit, me qëllim të parandalimit ose zvogëlimit të ndotjes dhe ruajtjes së mjedisit dhe shëndetit publik. Vlerësimi i ndikimit në mjedis bazohet në analizën e gjendjes ekzistuese të lokacionit, dokumentacionin teknik të objektit të ndërtuar dhe praktikën e mira për menaxhimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera të parrezikshme. Qëllimi kryesor i këtij raporti është identifikimi i burimeve të mundshme të ndikimit mjedisor, vlerësimi i shkallës së ndikimit të tyre dhe propozimi i masave për parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative brenda kufijve të lejuar ligjorë. Në përgjithësi, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për “2T COMPANY” SH.P.K. siguron që funksionimi i Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave të realizohet në mënyrë të kontrolluar, të sigurt dhe të qëndrueshme, në përputhje me kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Kodet e mbeturinave që trajtohen në këtë qendër janë paraqitur në tabelën vijuese.

2. KORNIZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e Qendres për Grumbullimin e Mbeturinave Metalike dhe Mbeturina tjerave sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinae, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar.

Shtojca 1 e këtij ligji, paragrafi 8:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181;
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;
- Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102;
- Ligji Nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri;
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233;

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzim Administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave;
- Udhëzim Administrativ (Mmphi) Nr.04/2025 për Pëmbajtjen, Metodologjinë dhe Përputhshmërinë e Raportit me Kërkesat Ligjore , Praktikën e Zbatueshme dhe Aspektet e Tjera Teknike Të Raportit
- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;

3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

Projekti i propozuar ka të bëjë me funksionimin (operimin) e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe mbeturinave të tjera jo të rrezikshme, nga kompania “2T COMPANY” SH.P.K., në Caravodicë, Komuna e Obiliqit (ngastra P-72614072-00486-1, ZK Caravodicë).

Qendra shërben për:

- pranimin e mbeturinave nga gjenerues të ndryshëm (biznese dhe persona),
- kontrollin fillestar (inspektim vizual dhe verifikim i llojit),
- ndarjen dhe klasifikimin sipas llojit të materialit,
- ruajtjen e përkohshme në hapësira të dedikuara,
- trajtimin fillestar (p.sh. selektim, grumbullim sipas fraksioneve, paketim/presim kur aplikohet),
- ngarkimin dhe dërgimin te operatorë të licencuar për riciklim ose trajtim të mëtejshëm.

Aktiviteti zhvillohet në një hapësirë operative ku planifikohet që procesi të jetë i kontrolluar dhe i rregullt, me rregulla të brendshme për pranim, magazinim dhe siguri, në mënyrë që të minimizohen ndikimet në mjedis (pluhur, zhurmë, derdhje aksidentale, rrjedhje ujërash të ndotura, etj.).

Mbeturinat që pranohen janë vetëm ato të lejuara sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave dhe që janë të përcaktuara në aktivitetin/lejimin e kompanisë. Kodet përkatëse paraqiten në tabelën e veçantë.

Tabela 1. Kodet e mbeturinave për aplikim

Tabelave e kodeve të kërkuara për pëlqim					
02 01 10	12 01 01	15 01 04	16 01 99	17 04 03	19 12 03
07 02 13	12 01 02	15 01 05	16 06 04	17 04 04	19 12 14
10 03 02	12 01 03	15 01 06	16 06 05	17 04 05	20 01 34
10 03 05	12 01 04	16 01 06	16 08 01	17 04 07	20 01 36
10 08 14	12 01 05	16 01 17	17 02 03	19 10 01	20 01 39
11 05 01	12 01 13	16 01 18	17 04 01	19 10 02	20 01 40
11 05 99	15 01 02	16 01 19	17 04 02	19 12 02	

Ne tabelën e mësipërme janë paraqitur Kodet e mbeturinave sipas U.A. Nr. 13 /2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave.

3.1.Kategoria e Projektit të Propozuar

Projekti bën pjesë në kategorinë e menaxhimit të mbeturinave, konkretisht:

- qendër për grumbullim dhe ruajtje të përkohshme, me trajtimi fillestar të mbeturinave,
- fokus kryesor: mbeturina metalike dhe mbeturina të tjera jo të rrezikshme.

Kategorizimi dhe detyrimi për trajtim përmes procedurave të VNM-së mbështetet në kërkesat e Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe në aktet nënligjore/listat e projekteve përkatëse për sektorin e mbeturinave, sipas vlerësimit të autoritetit kompetent.

3.2.Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Punët përgatitore për zbatimin e projektit kanë të bëjnë me organizimin funksional të objektit ekzistues dhe krijimin e kushteve të nevojshme për operimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave. Meqenëse objekti është i ndërtuar, punët përgatitore nuk përfshijnë ndërtime të reja, por fokusohen në rregullimin dhe pajisjen e hapësirave në përputhje me aktivitetin e planifikuar. Në kuadër të këtyre punëve parashihet përcaktimi dhe shënjimi i zonave funksionale për pranimin e mbeturinave, seleksionimin, copëtimin e mbeturinave metalike dhe ruajtjen e përkohshme të tyre, si dhe zonave të veçanta për grumbullimin dhe seleksionimin e mbeturinave të tjera. Po ashtu, do të bëhet sistemimi i sipërfaqeve të punës, vendosja e pajisjeve mekanike për copëtim dhe sigurimi i qasjes së brendshme për automjete dhe makineri. Gjatë kësaj faze do të bëhet edhe përgatitja e procedurave operative, trajnimi i stafit për menaxhimin e mbeturinave dhe zbatimin e masave mjedisore, si dhe përcaktimi i mënyrës së bashkëpunimit me operatorët e licencuar për trajtimin e mëtejshëm të mbeturinave. Të gjitha punët përgatitore do të realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të sigurimit të një operimi të rregullt, të sigurt dhe në përputhje me kërkesat mjedisore.

3.3.Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Funksionimi i Qendrës së Grumbullimit të “2T COMPANY” SH.P.K. në Caravodicë, Komuna e Obiliqit, është i organizuar si aktivitet i kontrolluar për pranimin, klasifikimin, ruajtjen e përkohshme dhe trajtimin fillestar të mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera jo të rrezikshme, me qëllim dërgimin e tyre për riciklim ose trajtim të mëtejshëm të operatorëve të licencuar. Këto aktivitete do të zhvillohen brenda hapësirave të dedikuara dhe të kontrolluara, pa përfshirë procese kimike apo termike. Funksionimi i qendrës zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të organizuar, duke respektuar procedurat operative për menaxhimin e mbeturinave, masat për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në punë. Proceset e punës janë të karakterit mekanik dhe monitorohen vazhdimisht për të parandaluar ndotjen e tokës, ajrit dhe

ujërave, si dhe për të minimizuar zhurmën dhe ndikimet tjera mjedisore. Gjatë operimit do të sigurohet ruajtja e përkohshme e mbeturinave në kushte të përshtatshme, sistemimi i rregullt i hapësirave të punës dhe dorëzimi i mbeturinave te operatorët e autorizuar për trajtim të mëtejshëm ose riciklim, në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe dokumentacionin përkatës.

3.4.Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit

Procesi i punës në Qendrën e Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave është i planifikuar dhe i organizuar në mënyrë të tillë që të sigurojë efikasitet operacional, siguri në punë dhe minimizim të ndikimeve mjedisore. Procesi zhvillohet në disa faza të ndërlidhura mes veti, duke filluar nga pranimi i mbeturinave deri te dorëzimi i tyre për trajtim të mëtejshëm.

Faza e parë – Pranimi dhe grumbullimi i mbeturinave metalike - Procesi fillon me pranimin e mbeturinave metalike nga qytetarët, bizneset private, kompanitë e ndryshme, punishtet, ndërmarrjet industriale dhe operatorë të tjerë, të cilat i dorëzojnë mbeturinat në hapësirat e dedikuara të qendrës. Në momentin e pranimit, automjetet dhe ngarkesat e sjella identifikohen dhe verifikohet që mbeturina është e lejuar sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave dhe kushteve të autorizimit. Pas verifikimit, bëhet faza e peshimit në peshore, ku regjistrohen të dhënat kryesore për automjetin, llojin e mbeturinës, datën, origjinën dhe peshën. Peshimi kryhet për të siguruar evidencë të saktë të sasive të pranura dhe të dorëzuara, për kontroll të brendshëm, raportim dhe menaxhim të stokut. Në varësi të organizimit të operimit, realizohet edhe peshimi pas shkarkimit ose në dalje, në mënyrë që të përcaktohet sasia neto.



Figura 1.Peshorja

Gjatë pranimit bëhet kontrolli vizual, identifikimi dhe klasifikimi i mbeturinave sipas llojit dhe kodit përkatës, në përputhje me Katalogun Shtetëror të Mbeturinave. Mbeturinat depozitohen përkohësisht në zona të caktuara brenda oborrit të objektit, të cilat janë të betonuara dhe të përshtatura për këtë veprimtari.



Figura 2. Pranimi i Mbeturinave

Faza e dytë – Seleksionimi paraprak - Pas grumbullimit, mbeturinat metalike i nënshtrohen seleksionimit paraprak. Në këtë fazë bëhet ndarja e metaleve sipas llojit, përmasës dhe karakteristikave fizike. Seleksionimi realizohet në mënyrë mekanike dhe manuale, me ndihmën e makinerive të rënda dhe pajisjeve ndihmëse. Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e materialit për procesin e copëtimit dhe rritja e efikasitetit të përpunimit.



Figura 3. Seleksionimi i Mbeturinave

Faza e tretë – Copëtimi mekanik i mbeturinave metalike - Mbeturinat metalike të seleksionuara i nënshtrohen procesit të copëtimit mekanik, përmes makinerive të posaçme. Copëtimi shërben për zvogëlimin e dimensioneve të mbeturinave, lehtësimin e manipulimit, optimizimin e hapësirës së ruajtjes dhe përgatitjen e materialit për transport dhe trajtim të mëtejshëm. Ky proces është plotësisht mekanik dhe nuk përfshin procese kimike apo termike.




Figura 4. Copëtimi i Mbeturinave



Figura 5. Produkti final

Pajisjet dhe mjetet e përdorura në proces - Gjatë të gjithave fazave të procesit përdoren vetëm pajisje dhe mjete mekanike, pa përdorim të substancave kimike. Pajisjet kryesore përfshijnë:

- kamionë me kran për manipulim dhe ngarkim,
- eskavatorë për grumbullim dhe zhvendosje të mbeturinave,
- shleperë dhe kamionë për transport të brendshëm dhe të jashtëm,
- shredderë dhe pajisje për copëtim mekanik,

Këto pajisje mirëmbahen rregullisht për të garantuar funksionim të sigurt dhe efikas.

Faza e katërt – Ruajtja e përkohshme dhe menaxhimi operacional - Pas copëtimit, mbeturinat metalike ruhen përkohësisht në zona të dedikuara dhe të shënuara qartë, deri në momentin e dorëzimit te operatorët e licencuar për riciklim ose trajtim të mëtejshëm. Ruajtja realizohet në mënyrë të kontrolluar, me qëllim të parandalimit të shpërndarjes së materialeve në mjedis dhe ndotjes së tokës apo ujërave.

Zgjerimi i aktivitetit për mbeturinat e tjera - Në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të projektit parashihet edhe shtimi i kategorive të reja të mbeturinave të plastikës sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave. Për këto mbeturina do të aplikohet një proces i ngjashëm pune, i cili përfshin grumbullimin, seleksionimin dhe copëtimin mekanik, në varësi të llojit dhe karakteristikave të tyre. Shtimi i këtyre aktiviteteve do të bëhet në mënyrë graduale dhe të kontrolluar, duke u bazuar në kapacitetet teknike ekzistuese dhe në përputhje me kërkesat ligjore mjedisore.

Planifikimi dhe kontrolli i procesit - Planifikimi i procesit të punës bëhet në bazë ditore dhe mujore, duke marrë parasysh sasinë e mbeturinave të pranuar, kapacitetin e pajisjeve dhe kërkesat për dorëzim. I gjithë procesi monitorohet vazhdimisht me qëllim të sigurimit të një operimi të rregullt, të sigurt dhe në përputhje me standardet për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit në punë.

3.5.Lënda e parë

Lënda e parë e cila hyn në objektin e kompoanisë është: Skrap i hekurit, skrap i bakerit, skrap aluminut (profil, alumin i but, karter, fellne, tel), mesing, zink, akumulator, plum, inox, mbeturine elektronike. Këto mbeturina sigurohen nga qytetarët dhe kompanit e ndryshme që krijojnë mbeturina.

3.6.Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Për funksionimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, nevojiten burime të ndryshme teknike,

njerëzore dhe energjetike, të cilat sigurojnë zhvillimin e rregullt dhe të sigurt të aktivitetit të planifikuar.

Burimet njerëzore - Funkcionimi i qendrës kërkon staf të kualifikuar për operimin e makinerive, seleksionimin e mbeturinave dhe menaxhimin e përgjithshëm të aktivitetit. Numri i të punësuarve përcaktohet në bazë të volumit të punës dhe kapaciteteve të qendrës, ndërsa personeli trajnohet për sigurinë në punë, mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e procedurave operative.

Burimet teknike dhe pajisjet - Burimet kryesore teknike përfshijnë makineri dhe pajisje për grumbullimin, seleksionimin dhe copëtimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera. Këtu bëjnë pjesë makineri për copëtim mekanik, ekskavatorë me griper, mjete transportuese të brendshme dhe pajisje ndihmëse për manipulimin e materialeve. Pajisjet janë të dizajnuara për punë industriale dhe operojnë në përputhje me standardet e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Burimet energjetike - Energjia elektrike përdoret për funksionimin e makinerive dhe pajisjeve, ndriçimin e objektit dhe sistemet mbështetëse. Konsumi i energjisë varet nga intensiteti i operimit dhe orari i punës, ndërsa furnizimi realizohet nga rrjeti ekzistues elektrik. Karburantet përdoren për funksionimin e makinerive të rënda dhe mjeteve transportuese brenda lokacionit.

Uji dhe burimet ndihmëse - Uji përdoret në sasi të kufizuara, kryesisht për nevoja sanitare dhe pastrimin e hapësirave të punës. Projekti nuk parashikon përdorim intensiv të ujit në procesin teknologjik të copëtimit apo seleksionimit të mbeturinave.

Burimet hapësinore - Për realizimin e aktivitetit shfrytëzohen hapësirat ekzistuese të objektit dhe oborrit, të cilat janë të ndara sipas funksionit për pranimin, seleksionimin, copëtimin dhe ruajtjen e përkohshme të mbeturinave. Organizimi hapësinor mundëson lëvizje të sigurt të makinerive dhe menaxhim të kontrolluar të materialeve.

Në tërësi, burimet e nevojshme për funksionimin e projektit janë të përmasave të menaxhueshme dhe të përshtatura me kapacitetet ekzistuese të qendrës, duke mundësuar zhvillimin e aktivitetit në mënyrë efikase, të sigurt dhe në përputhje me kërkesat ligjore mjedisore.

3.7.Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik

Gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të “2T COMPANY” SH.P.K., aktiviteti kryesor është pranimi, peshimi, seleksionimi, ruajtja e përkohshme dhe trajtimi fillestar i mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera jo të rrezikshme, me qëllim dërgimin e tyre te operatorë të

licencuar për riciklim ose trajtim të mëtejshëm. Si rrjedhojë, qendra nuk karakterizohet nga procese “prodhimi” që krijojnë emetime të mëdha teknologjike, por nga operime fizike ku burimet kryesore të ndikimit janë pluhuri, zhurma, emetimet nga automjetet dhe gjenerimi i mbeturinave të zakonshme nga personeli, si dhe sasi të minimale të mbetjeve të papërshtatshme që dalin gjatë seleksionimit.

Në aspektin e mbeturinave, duhet dalluar qartë se mbeturinat që “trajtohen” në qendër janë mbeturina hyrëse, të cilat pranohen dhe sistemohen për riciklim. Ndërsa mbeturinat që “gjenerohen” nga procesi i brendshëm i punës janë kryesisht: mbeturina komunale nga aktiviteti administrativ dhe i punëtorëve (ambalazhe ushqimore, letër, plastikë, mbetje higjienike), si dhe sasi të vogla të mbetjeve të përziera ose të papërshtatshme që mund të identifikohen gjatë kontrollit dhe seleksionimit (p.sh. papastërti, fraksione jo të dëshiruara, materiale të përziera që nuk plotësojnë kushtet e pranimit). Këto mbetje menaxhohen në mënyrë të veçantë, duke u grumbulluar në kontejnerë të mbyllur dhe duke u dorëzuar te operatorë të autorizuar/kompania e grumbullimit komunal, në përputhje me rregullat e komunës dhe kontratat përkatëse.

Emetimet kryesore në ajër gjatë procesit teknologjik përfshijnë krijimin e pluhurit dhe emetimet nga djegia e karburanteve të makinerive dhe mjeteve transportuese. Pluhuri krijohet kryesisht gjatë manipulimit dhe copëtimit mekanik të mbeturinave metalike dhe materiale të tjera, ndërsa intensiteti i tij varet nga lloji i materialit dhe kushtet atmosferike. Emetimet konsiderohen të lokalizuara dhe të përkohshme, dhe mund të kontrollohen përmes masave teknike dhe organizative. Proceset e copëtimit dhe funksionimi i makinerive të rënda shoqërohen me gjenerim të zhurmës dhe vibrimeve. Këto ndikime janë të kufizuara brenda lokacionit të projektit dhe zhvillohen kryesisht gjatë orarit të punës. Nivelet e zhurmës vlerësohen si të menaxhueshme përmes përdorimit të pajisjeve të mirëmbajtura dhe respektimit të orareve të lejuara të punës. Gjatë procesit teknologjik nuk parashihet gjenerim i ujërave teknologjike. Rreziku potencial për ndotje të tokës lidhet kryesisht me rrjedhje aksidentale të vajrave ose karburanteve nga makineritë, të cilat minimizohen përmes mirëmbajtjes së rregullt dhe masave parandaluese. Ujërat e shiut menaxhohen përmes sipërfaqeve të rregulluara dhe nuk parashihet ndotje e drejtpërdrejtë e ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore. Lloji dhe sasia e mbeturinave dhe emetimeve që gjenerohen gjatë procesit teknologjik konsiderohen të kufizuara dhe të kontrollueshme. Me zbatimin e masave adekuate për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit, funksionimi i projektit nuk pritet të shkaktojë ndikime të konsiderueshme negative në mjedis.

3.8.Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

Në kuadër të “2T COMPANY” SH.P.K., teknologjia e aplikuar lidhet me funksionimin e Qendrës së Grumbullimit, ku kryhet trajtimi fillestar dhe përgatitja e mbeturinave për dërgim në riciklim ose trajtim të mëtejshëm. Qendra nuk realizon trajtim final apo asgjësim përfundimtar në lokacion, por vepron si pikë e kontrolluar e pranimi, seleksionimit, ruajtjes së përkohshme dhe përpunimit fillestar (operime fizike) për mbeturina metalike dhe mbeturina të tjera jo të rrezikshme. Procesi zhvillohet pa trajtime kimike dhe pa procese që do të gjeneronin emetime të mëdha industriale.

Teknologjia e trajtimit dhe përpunimit fillestar bazohet në disa veprime kryesore: pranimi dhe kontrolli vizual, peshimi dhe regjistrimi, ndarja sipas fraksioneve, pastrimi i përafërt nga papastërtitë e dukshme, paketimi dhe sistemimi në kontejnerë ose grumbuj të kontrolluar, si dhe presimi kur aplikohet për optimizim të transportit. Ndarja realizohet kryesisht manualisht dhe me mjete pune, ndërsa për lëvizje dhe ngarkim përdoret mekanizim i përshtatshëm (p.sh. forklift/karroca, mjete ngarkuese), varësisht nga organizimi i qendrës.

Riciklimi dhe asgjësimi përfundimtar realizohen te operatorë të licencuar jashtë lokacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën e mira të menaxhimit të mbeturinave. Operatorët me të cilët punon kompania janë “Rec Kos” shpk dhe jashtë shtetit.

3.9.Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit

Megjithatë objekti është i ndërtuar, projekti nuk përfshin fazë ndërtimi, por fokusohet ekskluzivisht në fazën e operimit.

Qendra është planifikuar të funksionojë për një periudhë afatgjatë, pa kufizim të paracaktuar kohor, për atë kohë sa plotësohen kushtet ligjore, teknike dhe mjedisore për operim dhe ruhen lejet përkatëse. Gjatë gjithë periudhës së funksionimit, aktivitetet e grumbullimit, seleksionimit dhe copëtimit të mbeturinave metalike, si dhe menaxhimit të mbeturinave të tjera, do të zhvillohen në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me programin e punës dhe kapacitetet teknike të qendrës. Në rast të përfundimit të funksionimit të projektit, parashihet ndërprerja graduale e aktivitetit, largimi i mbeturinave të mbetura dhe çmontimi i pajisjeve teknologjike. Sipërfaqet e shfrytëzuara do të pastrohen dhe do të ndërmerren masa rehabilituese sipas

nevojës, përfshirë pastrimin e terrenit, largimin e materialeve të panevojshme dhe rikthimin e hapësirës në një gjendje të sigurt dhe të qëndrueshme nga aspekti mjedisor.

3.10. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Funksionimi i Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave kërkon infrastrukturë funksionale dhe të përshtatshme, e cila siguron zhvillimin e rregullt të aktiviteteve dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore. Projekti shfrytëzon infrastrukturën ekzistuese të lokacionit, e cila është e mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë së planifikuar. Lokacioni është i qasshëm përmes rrugëve ekzistuese, të cilat mundësojnë hyrjen dhe daljen e automjeteve transportuese dhe makinerive të rënda. Brenda lokacionit janë të organizuara rrugë të brendshme funksionale për lëvizjen e mjeteve dhe manipulimin e mbeturinave. Kompania është e pajisur me trafo personale, e cila siguron furnizim të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm me energji elektrike për funksionimin e pajisjeve teknologjike, ndriçimin e objektit dhe sistemet mbështetëse. Kjo infrastrukturë mundëson operim të pavarur dhe të sigurt nga aspekti energjetik. Uji përdoret kryesisht për nevoja sanitare dhe pastrimin e hapësirave të punës, uji merret nga rrejtja e ujësjellësit. Kanalizimi i ujërave të përdorura realizohet përmes gropës septike, e cila është e pajisur me dy ndarës për ndarjen e vajrave dhe yndyrave, me qëllim të parandalimit të ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore. Mirëmbajtja dhe zbrazja e gropës septike realizohet nga operatorë të autorizuar. Ujërat e reshjeve menaxhohen përmes sipërfaqeve të rregulluara dhe pjerrësive të terrenit, duke parandaluar grumbullimin e tyre dhe rrezikun e ndotjes së tokës apo ujërave përreth. Infrastruktura ekzistuese është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për funksionimin e projektit, duke mundësuar zhvillimin e aktivitetit në mënyrë të kontrolluar, të sigurt dhe në përputhje me kërkesat mjedisore.

3.11. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Për zbatimin dhe funksionimin e projektit për operimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave nuk parashihen aktivitete shtesë ndërtimore, si ndërtimi i kampeve të përkohshme, rezidencave për punëtorë apo objekteve të tjera ndihmëse. Aktiviteti zhvillohet brenda objektit dhe hapësirave ekzistuese të kompanisë “2T COMPANY” SH.P.K., të cilat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për operim, përfshirë hapësira administrative, sanitare dhe zona për personelin. Staf i angazhohet nga zona përreth dhe nuk ka nevojë për akomodim të përkohshëm brenda lokacionit. Çdo aktivitet ndihmës që mund të nevojitet gjatë operimit, si mirëmbajtja e

pajisjeve, furnizimi me materiale ndihmëse apo shërbime teknike, realizohet përmes operatorëve dhe shërbimeve të jashtme të autorizuar, pa krijuar nevojë për ndërtime apo ndërhyrje shtesë në hapësirë. Në këtë kontekst, projekti zbatohet pa nevojë për aktivitete shtesë që do të kishin ndikim të ri ose shtesë në mjedis, përtej atyre të përshkruara në kapitujt paraprakë.

3.12. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Për realizimin e projektit për operimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, kompania “2T COMPANY” SH.P.K. është e obliguar të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Lejet dhe autorizimet kryesore që kërkohen për zbatimin e projektit përfshijnë:

1. **Pëlqimi komunal**, i lëshuar nga komuna ku realizohet aktiviteti, për ushtrimin e veprimtarisë në lokacionin përkatës.
2. **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)**, i miratuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181.
3. **Leja Mjedisore**, e lëshuar nga MMPHI për operimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave.

Të gjitha lejet dhe licencat përkatëse do të sigurohen dhe mirëmbahen gjatë gjithë periudhës së funksionimit të projektit. Aktiviteti i kompanisë do të zhvillohet në përputhje të plotë me kushtet e lejeve të lëshuara, duke garantuar funksionim të rregullt, të ligjshëm dhe në përputhje me kërkesat mjedisore dhe rregullatore në fuqi.

3.13. Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Projekti për operimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave nga kompania “2T COMPANY” SH.P.K. zhvillohet në një zonë ku janë të pranishme edhe projekte dhe aktivitete të tjera ekzistuese me karakter industrial dhe energjetik. Si i tillë, projekti ka ndërlidhje funksionale dhe hapësinore me disa aktivitete përreth, pa krijuar mbivendosje direkte të proceseve teknologjike. Në afërsi të lokacionit ndodhen objekte dhe aktivitete industriale/energjetike, si: Kosovamont (rreth **635 m**), Deponia e Mbeturinave Komunale (rreth **1.15 km**), Deponia e Hirit e TC Kosova B (rreth **1.65 km**), Azotika (rreth **1.39 km**), Termocentrali Kosova A (rreth **2.22 km**), Deponia e Qymyrit e TC Kosova A (rreth **2.20 km**), Deponia e Qymyrit e TC Kosova B (rreth **1.53 km**),

si dhe Termocentrali Kosova B (rreth **1.73 km**). Këto projekte funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe kanë infrastrukturë, procese teknologjike dhe leje të veçanta. Ndërlidhja e projektit me aktivitetet e lartpërmendura konsiston kryesisht në shfrytëzimin e infrastrukturës së përbashkët rrugore dhe në kontekstin e zhvillimit industrial të zonës. Projekti nuk është teknologjikisht i varur nga këto aktivitete dhe nuk parashihet shkëmbim direkt i materialeve, mbeturinave apo rrjedhave teknologjike ndërmjet tyre. Duke qenë se projekti zhvillohet në një zonë tashmë të ngarkuar me aktivitete industriale, ndikimet kumulative mjedisore konsiderohen të kufizuara dhe të menaxhueshme, me kusht që secili aktivitet të funksionojë në përputhje me lejet dhe masat mjedisore përkatëse. Funksionimi i Qendrës së Grumbullimit nuk pritet të rrisë ndjeshëm ngarkesën ekzistuese mjedisore të zonës dhe nuk krijon ndërvarësi operative me projektet e tjera ekzistuese.




Figura 6. Distanca me biznese tjera

4. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

4.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti

Projekti për operimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, nga kompania “2T COMPANY” SH.P.K., është në territorin e Komunës së Obiliqit.

Lokacioni i projektit shtrihet në Zonën Kadastrale Caravodicë, në parcelën kadastrale:

➤ P-72614072-00486-1

Ngastra e përmendur ndodhet brenda kufijve administrativë të Komunës së Obiliqit dhe shfrytëzohet për operimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave, përfshirë zonat për pranimin e mbeturinave, grumbullimin, seleksionimin dhe copëtimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinat tjera të parrezikshme sipas katalogut shtetëror të mbeturinave, hapësirat për ruajtje të përkohshme, rrugët e brendshme të qarkullimit dhe infrastrukturën përcjellëse, në përputhje me dokumentacionin teknik dhe kushtet mjedisore në fuqi.

4.2. Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit

Vendndodhja e projektit për operimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave është paraqitur përmes skicës dhe planimetrisë përkatëse, të cilat ilustrjnë shtrirjen hapësinore të projektit në nivel lokal dhe rajonal. Këto skica shërbejnë për të paraqitur në mënyrë vizuale pozicionin e projektit në raport me territorin e Republikës së Kosovës, Komunën e Obiliqit dhe zonën kadastrale përkatëse. Në planimetrinë e përgjithshme paraqitet pozicioni i projektit brenda territorit të Republikës së Kosovës, me theks të veçantë në rajonin qendror dhe Komunën e Obiliqit, duke mundësuar identifikimin e qartë të lokacionit në kontekst më të gjerë gjeografik. Kjo skicë ofron një pasqyrë orientuese të vendndodhjes së projektit në raport me zonat përreth dhe aktivitetet industriale ekzistuese. Planimetria në nivel lokal paraqet në mënyrë të detajuar shtrirjen e parcelës kadastrale ku zhvillohet projekti, përkatësisht parcelën P-72614072-00486-1 në Zonën Kadastrale Caravodicë, Komuna e Obiliqit. Në këtë planimetri janë të evidentuara hapësirat funksionale të qendrës, përfshirë zonat për pranimin, grumbullimin, seleksionimin dhe copëtimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinave tjera sipas katalogut shtetëror të mbeturinave. Në vijim është paraqitur shtrirja hapësinore e projektit në lokacionin e paraparë për operim, e cila ofron një pasqyrë të qartë të organizimit hapësinor të aktivitetit dhe ndërveprimit të tij me mjedisin përreth.




Figura 7. Shtrirja hapësimore e Lokacionit të projektit që do të ndërtohet në territorin e Komunës së Obiliqit

Në skicat përkatëse është paraqitur gjithashtu lidhja rrugore e lokacionit të projektit me qytetin e Obiliqit dhe zonat përreth, përmes rrjetit ekzistues rrugor. Kjo lidhje siguron qasje funksionale për automjetet transportuese, makineritë dhe aktivitetet e përditshme të operimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave, pa pasur nevojë për ndërhyrje të mëdha infrastrukturore apo ndërtim të rrugëve të reja.




Figura 8. Distanca e kompanisë me qytetin e Obiliqit

4.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti

Distanca ndërmjet lokacionit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave dhe qendrave të banuara përreth është vlerësuar në bazë të matjeve hapësinore të paraqitura në skicat dhe planimetrinë përkatëse. Analiza është realizuar duke marrë parasysh kufijtë e parcelës kadastrale P-72614072-00486-1 dhe objektet më të afërta të banuara në zonën përreth. Bazuar në të dhënat e matjes, rezulton se distanca minimale ndërmjet lokacionit të projektit dhe objekteve më të afërta të banuara është rreth 102 m. Këto distanca tregojnë se lokacioni i projektit është i ndarë në mënyrë të mjaftueshme nga zonat e banuara.



Figura 9. Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi

Duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit, i cili përfshin grumbullimin, seleksionimin dhe copëtimin mekanik të mbeturinave, pa përfshirë procese kimike apo termike, pozicionimi hapësinor i projektit nuk pritet të shkaktojë ndikime të konsiderueshme negative në qendrat e banuara përreth, pasi që sipas hartës zonale, është pjesë nën ndikimin e termocentralit.

Gjithashtu vlen të theksohet që shtëpitë të cilat janë të vendosura ngjithërisht me kompaninë, janë të pronarëve të kompanisë.



Figura 10. Distanca ndermjet kompanise dhe shtepive te pronareve

4.4.Paraqitje e karakteristikat pedologjike, geomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit

Nga aspekti geomorfologjik, territori i Komunës së Obiliqit paraqitet kryesisht si zonë fushore dhe kodrinore e ulët. Relievi është përgjithësisht i rrafshët, me pjerrësi të vogla, çka e bën të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve industriale dhe infrastrukturore. Në materialet e paraqitura nuk evidentohen forma geomorfologjike të paqëndrueshme apo procese aktive erozive që do të paraqisnin kufizime për zhvillimin e projektit. Sipas të dhënave gjeologjike të paraqitura në PZHK, përbërja gjeologjike e territorit të Komunës së Obiliqit dominohet nga formacionet sedimentare. Nga tabela përkatëse rezulton se rreth 43.98% e territorit përbëhet nga balta, rëra, zhavorri dhe marlina, pjesërisht me linjit. Përbërja lymore zë rreth 21.79%, ndërsa proluviumi përbën rreth 12.04% të sipërfaqes. Në përqindje më të vogël paraqiten edhe aluvionet, sedimentet e liqeneve dhe lumenjve, mermeri, shkëmbinjtë gëlqerorë, kuarcitet dhe formacione të tjera magmatike e metamorfike. Kjo përbërje gjeologjike është tipike për zonat fushore të Kosovës dhe konsiderohet e përshtatshme për veprimtari industriale. Bazuar në përshkrimin hidrografik të paraqitur në PZHK, territori i Komunës së Obiliqit përshkohet nga tre lumenj natyrorë: Sitnica, Drenica dhe Llapi, si dhe nga Kanali Ibër–Lepenc. Lumi Sitnica

përbën rrjedhën kryesore ujore dhe përshkon territorin e komunës nga jugu në veri, duke mbledhur rreth 80% të ujërave në drejtim të veriperëndimit. Sitnica karakterizohet nga prurje të ulëta gjatë stinës së verës dhe prurje shumë më të larta gjatë dimrit dhe pranverës, veçanërisht gjatë shkrirjes së borës, kur prurjet mund të arrijnë deri në 37.5 m³/s. Në raste të prurjeve të mëdha, lumi mund të dalë nga shtrati dhe të përmbytë tokat përreth.

4.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Furnizimi me ujë për nevojat e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, që operohet nga kompania “2T COMPANY” SH.P.K., realizohet përmes rrjetit publik të ujësjellësit. Uji shfrytëzohet kryesisht për nevoja sanitare dhe higjienike të stafit, si dhe për pastrim të hapësirave operative, pa përdorim të ujit në procese teknologjike. Bazuar në të dhënat hapësinore të paraqitura në planimetrinë përkatëse, lumi Sitnica kalon në afërsi të lokacionit të projektit, në një distancë prej rreth 236 m nga kufijtë e parcelës. Projekti nuk parashikon marrje uji nga lumi Sitnica dhe nuk ka ndërhyrje direkte në shtratin apo rrjedhën e tij. Duke marrë parasysh mënyrën e furnizimit me ujë dhe mungesën e shfrytëzimit të burimeve sipërfaqësore apo nëntokësore, projekti nuk pritet të ketë ndikim negativ në burimet ujore përreth.



Figura 11. Distanca e projektit nga lumi Sitnica

4.6.Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik

Bazuar në të dhënat e paraqitura në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Obiliqit 2022–2030, territori i komunës, përfshirë edhe zonën ku ndodhet lokacioni i projektit, i nënshtrohet ndikimeve klimatike të pellgut të Sitnicës dhe Ibërit. Zona karakterizohet nga një mikroklimë me specifika të veçanta, e ndikuar nga zhvillimi industrial dhe proceset kimiko-teknologjike të aktiviteteve energjetike në rajon. Proceset e emisioneve industriale kanë ndikuar në përhapjen e aerosoleve dhe elementeve të tjera klimatologjike, duke reflektuar veçanërisht në nivelet e lagështisë relative. Në këtë zonë, lagështia relative paraqitet e lartë dhe varion në intervalin prej 47% deri në 95%, ndërkohë që kufijtë normalë zakonisht janë 45%–56%. Temperatura e ajrit paraqitet e ndryshueshme gjatë vitit. Vlera mesatare vjetore e temperaturës është rreth 10.2 °C. Muaji më i ftohtë është janari, me temperaturë mesatare rreth –1.5 °C, ndërsa muaji më i nxehtë është gushti, me temperaturë mesatare rreth 20.5 °C. Amplituda vjetore e temperaturës së ajrit arrin rreth 21.9 °C, duke reflektuar një regjim klimatik kontinental. Regjimi klimatik i zonës klasifikohet si klimë mesatare kontinentale, me ndikime të klimës malore, ku vjeshta është mesatarisht më e ngrohtë se pranvera për rreth 1.5 °C. Sa i përket reshjeve atmosferike, zona ndikohet nga aktivitetet ciklonike me prejardhje të ndryshme. Masat ajrore të lagështa dhe të ftohta nga Atlantiku ndikojnë kryesisht gjatë periudhës së vjeshtës dhe dimrit, ndërsa gjatë verës dhe pranverës ndikojnë masat ajrore më të thata nga jugu, hapësira mesdhetare dhe masat e ftohta nga veriu dhe verilindja. Sasia vjetore e reshjeve varion në intervalin prej 670 mm deri në 810 mm. Në aspektin e erërave, drejtimet dominuese janë:

- Veri–Verilindje me rreth 20.3%;
- Veri me rreth 19.4%;
- Jug me rreth 5%;
- Perëndim me rreth 4%.

Era nga drejtimi verilindor është më e shpeshtë gjatë pranverës dhe më e rrallë gjatë dimrit. Qetësia më e madhe e erës vërehet në muajin gusht, ndërsa qetësia më e vogël në muajin prill. Shpejtësia mesatare më e lartë e erës regjistrohet zakonisht në muajin mars, me vlerë rreth 3.2 m/s, ndërsa shpejtësia më e ulët regjistrohet në muajin shtator, me rreth 1.8 m/s.

4.7.Karakteristikat natyrore

Zona ku ndodhet lokacioni i Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave karakterizohet nga elemente natyrore tipike për territorin e Komunës së Obiliqit dhe Rrafshin e Kosovës. Mjedisi natyror i zonës është i ndikuar në masë të konsiderueshme nga zhvillimi industrial, infrastruktura

energjetike dhe aktivitetet antropogjene të zhvilluara ndër vite. Vegetacioni natyror përreth lokacionit përbëhet kryesisht nga bimësi barishtore dhe shkurre, me prezencë të kufizuar të drurëve përgjatë rrjedhave ujore. Nuk evidentohet prani e pyjeve të dendura, habitateve të mbrojtura apo ekosistemeve natyrore me vlera të veçanta ekologjike në zonën e drejtpërdrejtë të projektit. Fauna e zonës përbëhet kryesisht nga specie të zakonshme të ambientit fushor dhe bujqësor, të cilat janë të përshtatura ndaj pranisë së aktiviteteve industriale dhe qarkullimit të mjeteve. Nuk janë identifikuar specie të rralla, të mbrojtura apo të rrezikuara që do të ndikonin në realizimin e projektit. Territori përreth lokacionit përfshin toka bujqësore, zona industriale ekzistuese dhe infrastrukturë rrugore, ndërsa elementet natyrore janë të fragmentuara për shkak të shfrytëzimit të vazhdueshëm të hapësirës. Afërsia e lumit Sitnica përbën elementin kryesor natyror hidrografik në zonë, megjithatë projekti nuk ka ndërhyrje direkte në mjedisin natyror të tij. Në përgjithësi, karakteristikat natyrore të zonës konsiderohen të zakonshme për këtë pjesë të Kosovës dhe nuk paraqesin ndjeshmëri të veçantë ekologjike. Për këtë arsye, funksionimi i projektit nuk pritet të shkaktojë ndikime të konsiderueshme negative në aspektin e elementeve natyrore, për aq kohë sa zbatohen masat mjedisore të parashikuara.

4.8.Karakteristikat themelore të peizazhit

Peizazhi i zonës ku ndodhet lokacioni i Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave karakterizohet nga një kombinim i elementeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu. Zona bën pjesë në territorin fushor të Komunës së Obiliqit, ku peizazhi është formësuar kryesisht nga zhvillimi industrial, aktivitetet energjetike. Nga aspekti vizual, peizazhi dominohet nga objekte dhe struktura industriale ekzistuese, infrastrukturë rrugore, zona të shfrytëzuara për veprimtari ekonomike, si dhe sipërfaqe të hapura me përdorim bujqësor. Elementet natyrore, si bimësia barishtore dhe shkurre, janë të shpërndara në mënyrë të fragmentuar dhe kanë rol sekondar në formësimin e peizazhit. Afërsia e lumit Sitnica paraqet elementin kryesor natyror në peizazh, duke krijuar një korridor linear përgjatë rrjedhës së tij, megjithatë ndikimi vizual i këtij elementi është i kufizuar për shkak të ndërhyrjeve të shumta antropogjene në zonë. Nuk identifikohen pamje panoramike me vlera të veçanta estetike apo peizazhe të mbrojtura në afërsi të drejtpërdrejtë të projektit. Duke qenë se projekti zhvillohet në një lokacion ekzistues industrial, funksionimi i Qendrës së Grumbullimit nuk pritet të sjellë ndryshime të ndjeshme në karakterin e peizazhit. Aktivitetet e propozuara përshtaten me strukturën vizuale ekzistuese të zonës dhe nuk krijojnë kontraste të reja të theksuara në peizazh. Në përgjithësi, peizazhi i zonës konsiderohet me vlera

të zakonshme estetike dhe me ndjeshmëri të ulët ndaj ndryshimeve, prandaj ndikimi i projektit në aspektin e peizazhit vlerësohet si i kufizuar dhe i pranueshëm.

4.9.Objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit planifikues në fuqi, përfshirë Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Obiliqit, si dhe në vëzhgimin e gjendjes ekzistuese në terren, në lokacionin ku zhvillohet Qendra e Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave dhe në afërsi të drejtpërdrejtë të tij nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, historike apo arkeologjike. Po ashtu, në zonën e ndikimit të projektit nuk evidentohet prani e monumenteve kulturore, zonave të mbrojtura kulturore apo objekteve me vlera historike të shpallura sipas legjislacionit në fuqi. Projekti zhvillohet në një zonë me karakter industrial, e cila është shfrytëzuar ndër vite për aktivitete ekonomike dhe industriale. Në këtë kontekst, realizimi dhe funksionimi i projektit nuk pritet të ketë ndikime negative në trashëgiminë kulturore dhe historike, dhe nuk kërkohen masa të veçanta mbrojtëse për këtë aspekt.

4.10. Të dhënat për popullsinë dhe karakteristikat demografike

Bazuar në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, të paraqitura në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Obiliqit, në territorin e komunës jetojnë gjithsej 21,549 banorë të shpërndarë në 20 vendbanime. Struktura moshore e popullsisë tregon se pjesa më e madhe e banorëve i përket grup-moshës aktive 20–64 vjeç, me 55.19% të popullsisë, ndërsa grup-moshat 0–4 vjeç përbëjnë 9.69%, 5–14 vjeç 20.10%, 15–19 vjeç 9.27% dhe personat mbi 65 vjeç 5.75%. Kjo strukturë tregon një popullsi relativisht të re dhe aktive nga aspekti ekonomik.

Sa i përket përbërjes etnike, 92.13% e popullsisë i përket etnisë shqiptare, ndërsa pjesa tjetër përbëhet kryesisht nga komunitetet rome, ashkali dhe serbe, si dhe grupe të tjera etnike në përqindje shumë më të vogla. Për nga përkatësia fetare, dominon besimi islam me 97.68% të popullsisë, ndërsa besimi ortodoks, katolik dhe përkatësitë tjera përfaqësohen në përqindje të vogla.

Në Komunën e Obiliqit janë regjistruar gjithsej 3,852 ekonomi familjare, prej të cilave 33.02% ndodhen në zonë urbane dhe 66.98% në zonë rurale. Numri më i madh i ekonomive familjare përbëhet nga familje me pesë anëtarë, të ndjekura nga familjet me gjashtë anëtarë. Struktura gjinore e popullsisë është relativisht e balancuar, me një dallim minimal ndërmjet meshkujve dhe femrave, ku meshkujt përbëjnë rreth 2.03% më shumë se femrat.

Territori i Komunës së Obiliqit shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 105 km², me një dendësi mesatare të popullsisë prej rreth 205 banorë për km², ndërsa dendësia ndryshon nga një vendbanim në tjetrin, me vlera më të larta në zonat urbane dhe më të ulëta në zonat rurale. Duke marrë parasysh karakterin industrial të zonës ku zhvillohet projekti dhe largësinë nga qendrat e banuara, realizimi dhe funksionimi i projektit nuk pritet të ketë ndikime të drejtpërdrejta në strukturën demografike, shpërndarjen e popullsisë apo karakteristikat sociale të komunës.

4.11. Në Zonat me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore në hapësirën e projektit

Bazuar në analizën e dokumentacionit planifikues në fuqi, përfshirë Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Obiliqit, si dhe në shqyrtimin e gjendjes ekzistuese në terren, në hapësirën ku zbatohet projekti i Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, si dhe në afërsi të drejtpërdrejtë të tij, nuk janë identifikuar zona me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike apo mjedisore.

Në kufijtë e parcelës së projektit nuk evidentohet prania e rezervateve natyrore ose zonave të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi, zonave të mbrojtura të biodiversitetit apo korridoreve ekologjike të përcaktuara, zonave me ndjeshmëri të lartë ekologjike, zonave të dedikuara për kërkime shkencore ose përdorime të veçanta akademike.

Zona ku propozohet projekti karakterizohet nga përdorim ekzistues dhe i mëhershëm industrial, me ndërhyrje antropogjene të dukshme, çka e zvogëlon ndjeshmërinë mjedisore të territorit dhe e bën atë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive të tilla. Sa i përket trashëgimisë arkeologjike, në lokacionin e projektit dhe rreth tij nuk janë të njohura apo të regjistruara vende arkeologjike apo objekte me vlera historike dhe kulturore. Megjithatë, gjatë fazës së ndërtimit dhe punimeve tokësore, do të respektohen plotësisht procedurat ligjore në fuqi dhe, në rast të zbulimeve të rastësishme të ndonjë elementi me vlera arkeologjike apo kulturore, punimet do të ndërpriten menjëherë dhe do të njoftohen institucionet kompetente për veprime të mëtejme. Realizimi i projektit nuk pritet të ketë ndikime negative në zona me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike apo mjedisore, dhe konsiderohet i pranueshëm nga ky aspekt, me kusht zbatimin e plotë të masave ligjore dhe procedurale të parapara

5. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR

5.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor

Bazuar në të dhënat e Planit Zhvillimor Komunal të Obiliqit dhe gjendjen ekzistuese në terren, konsiderohet një nga zonat me ngarkesën më të lartë mjedisore në Kosovë. Faktorët kryesorë që ndikojnë në cilësinë e mjedisit lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet energjetike, industriale dhe minerare, “Kosova A” dhe “Kosova B”, minierat sipërfaqësore të linjtit, deponitë e hirit dhe aktivitetet urbane. Gjendja e ajrit karakterizohet nga nivele të larta të ndotjes, sidomos në zonat përreth kapaciteteve industriale dhe energjetike. Proceset e djegies së linjtit në termocentrale gjenerojnë emetime të konsiderueshme të pluhurit, gazrave ndotës si SO₂, NO_x, CO, CO₂, si dhe grimca të metaleve të rënda. Këto emetime ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ajrit dhe paraqesin rrezik për shëndetin e popullatës, veçanërisht në vendbanimet afër zonave industriale si Obiliqi, Millosheva, Mazgiti dhe Plemetini. Në territorin e komunës funksionojnë pika monitoruese të cilësisë së ajrit, të cilat tregojnë se ndotja e ajrit është një problem i vazhdueshëm dhe i ndërlidhur ngushtë me aktivitetet industriale dhe trafikun rrugor. Sa i përket ujërave, lumi Sitnica përbën receptorin kryesor të ndotjes ujore në territorin e Komunës së Obiliqit. Ndotja e tij vjen kryesisht nga shkarkimet e ujërave të zeza urbane dhe industriale, si dhe nga aktivitetet e KEK-ut. Të dhënat tregojnë prani të rritur të parametrave ndotës si nitratat, nitritet, fenolët dhe vlera të larta të pH-së, duke e renditur Sitnicën ndër lumenjtë më të ndotur në Kosovë. Përveç ujërave sipërfaqësore, ndikimi negativ shtrihet edhe në ujërat nëntokësore, veçanërisht në zonat ku popullata përdor puse për furnizim me ujë, çka paraqet rrezik potencial për shëndetin publik. Gjendja e tokës është e ndikuar ndjeshëm nga aktivitetet industriale dhe deponitë e hirit. Sipërfaqe të konsiderueshme toke janë degraduar nga depozitimi i hirit të termocentraleve, minierat sipërfaqësore dhe aktivitetet ndihmëse. Në disa zona vërehet ndotje e tokës nga metale të rënda, mbetje industriale dhe urbane. Kjo gjendje ka ndikuar negativisht në përdorimin bujqësor të tokës dhe në cilësinë e mjedisit jetësor. Zhurma përbën një tjetër faktor mjedisor me ndikim të theksuar në zonë. Burimet kryesore të zhurmës lidhen me aktivitetet minerare, transportin e linjtit, funksionimin e termocentraleve, pajisjet industriale dhe trafikun e rënduar. Në disa zona, nivelet e zhurmës tejkalojnë vlerat e rekomanduara, duke ndikuar në cilësinë e jetës së banorëve përreth. Gjendja aktuale e faktorëve karakterizohet nga presion i lartë mjedisor, i shkaktuar nga ndërthurja e aktiviteteve industriale, energjetike dhe urbane. Kjo gjendje kërkon zbatim të vazhdueshëm të masave mbrojtëse, monitorim të rregullt të parametrave mjedisorë dhe përmirësim të praktikave të menaxhimit të mjedisit, me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative dhe mbrojtjes së shëndetit publik.

6. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

6.1.Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Janë shqyrtuar disa alternativa të realizueshme për zhvillimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave:

- a) Operimi i qendrës në lokacionin ekzistues, me grumbullim, seleksionim dhe copëtim të mbeturinave metalike, si dhe grumbullim dhe seleksionim të mbeturinave të tjera që planifikohet të shtohen.
- b) Operimi i qendrës vetëm për grumbullim dhe seleksionim të mbeturinave metalike, pa copëtim dhe pa përfshirje të mbeturinave të tjera.
- c) Zhvendosja e aktivitetit në një lokacion tjetër me karakteristika të ngjashme.

Alternativa kryesore e analizuar është alternativa (A), e cila vlerësohet si më e përshtatshme nga aspekti teknik, mjedisor dhe funksional, pasi shfrytëzon infrastrukturën ekzistuese dhe siguron menaxhim më efikas të mbeturinave me ndikime të kontrollueshme në mjedis.

6.2. Arsyt kryesore për zgjedhjen e alternativës së propozuar

Alternativa e përzgjedhur ofron zgjidhjen më të përshtatshme ndërmjet funksionalitetit, ndikimit mjedisor dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të projektit. Shfrytëzimi i lokacionit ekzistues dhe i infrastrukturës së ndërtuar mundëson zhvillimin e aktivitetit pa nevojë për ndërhyrje shtesë ndërtimore, duke zvogëluar ndikimet mjedisore dhe kostot investive. Kjo alternativë siguron menaxhim më efikas të mbeturinave metalike përmes grumbullimit, seleksionimit dhe copëtimit, si dhe krijon mundësi për zgjerim të kontrolluar me përfshirjen e llojeve të tjera të mbeturinave sipas Katalogut Shtetëror. Në të njëjtën kohë, kontribuon në uljen e sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi, rrit shkallën e riciklimit dhe mbështet parimet e ekonomisë qarkore. Alternativa e propozuar është në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe politikat kombëtare për menaxhimin e mbeturinave, duke garantuar operim të qëndrueshëm dhe ndikime të kontrollueshme në mjedis dhe shëndetin publik.

6.3.Vendndodhja ose rruga

Lokacioni ka qasje të drejtpërdrejtë dhe funksionale rrugore përmes rrjetit ekzistues, duke mundësuar hyrje dhe dalje të mjeteve transportuese pa nevojë për ndërtim të rrugëve të reja. Afërsia me infrastrukturën industriale dhe energjetike ekzistuese e bën këtë vendndodhje të favorshme nga aspekti teknik, logjistik dhe mjedisor për realizimin dhe operimin e projektit.

6.4.Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Projekti zhvillohet në një lokacion ekzistues dhe nuk përfshin fazë ndërtimi, prandaj nuk parashikohen ndikime ndërtimore në mjedis. Gjatë operimit mund të paraqiten ndikime të

kufizuara, si pluhur dhe zhurmë nga lëvizja e mjeteve dhe proceset mekanike, të cilat janë të menaxhueshme me masa parandaluese. Projekti nuk gjeneron ujëra të ndotura teknologjike dhe nuk ka emisione të konsiderueshme në ajër. Nga aspekti i shëndetit të njeriut, aktiviteti është i pranueshëm dhe kontribuon pozitivisht përmes rritjes së riciklimit dhe uljes së sasisë së mbeturinave që përfundojnë në deponi.

6.5.Proceset dhe teknologjia e prodhimit

Proceset teknologjike të projektit bazohen në grumbullimin, seleksionimin dhe copëtimin mekanik të mbeturinave metalike dhe mbeturina tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave. Mbeturinat metalike pranohen në lokacion, kontrollohen, ndahen sipas llojit dhe përbërjes, dhe më pas, sipas nevojës, i nënshtrohen procesit të copëtimit për përgatitje për riciklim ose dërgim te operatorë të autorizuar. Procesi është kryesisht mekanik dhe nuk përfshin trajtime kimike apo termike. Pajisjet e përdorura janë makineri për seleksionim dhe copëtim, mjete ngritëse dhe transportuese, si dhe hapësira për ruajtje të përkohshme të materialeve. Teknologjia e aplikuar synon rritjen e efikasitetit të menaxhimit të mbeturinave, zvogëlimin e volumit të tyre dhe përgatitjen për riciklim, me ndikime të kontrollueshme në mjedis.

6.6.Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit

Projekti nuk përfshin punime ndërtimore, pasi zhvillohet në lokacion ekzistues. Gjatë funksionimit, puna realizohet përmes proceseve mekanike të grumbullimit, seleksionimit dhe copëtimit të mbeturinave metalike, si dhe grumbullimit dhe seleksionimit të mbeturinave të tjera, duke respektuar standardet e sigurisë dhe mbrojtjes mjedisore.

6.7.Plani i lokacionit

Plani i lokacionit parasheh organizim funksional të hapësirës ekzistuese, duke përfshirë zonat për pranimin e mbeturinave, seleksionimin, copëtimin e mbeturinave metalike, ruajtjen e përkohshme, rrugët e brendshme dhe hapësirat administrative.

6.8.Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit

Materialet dhe pajisjet e përdorura janë makineri për seleksionim dhe copëtim, kontejnerë për ruajtje të mbeturinave, mjete ngritëse dhe transportuese, si dhe pajisje mbrojtëse për punëtorët, të gjitha të certifikuara dhe të përshtatshme për përdorim industrial.

6.9.Afat i kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Projekti është funksional dhe parashihet të operojë afatgjatë, pa afat të paracaktuar për përfundimin e aktivitetit, për aq kohë sa respektohen kushtet ligjore dhe mjedisore në fuqi.

6.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Aktiviteti zhvillohet në parcelën kadastrale të kompanisë, me sipërfaqe prej 7848.6 m², e cila është e mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit të planifikuar dhe infrastrukturën përcjellëse.

6.11. Vëllimi i prodhimit

Projekti nuk përfshin prodhim, por menaxhim të mbeturinave. Vëllimi i aktivitetit varet nga sasia e mbeturinave të pranura dhe të trajtuara sipas kapaciteteve operative të qendrës.

6.12. Kontrolli i ndotjes

Kontrolli i ndotjes gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të bazohet në masa organizative dhe teknike që synojnë parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në ajër, tokë dhe ujë, si dhe mbajtjen e aktivitetit brenda kufijve të lejuar ligjorë. Duke qenë se aktiviteti kryesor është pranimi, peshimi, seleksionimi dhe ruajtja e përkohshme e mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera jo të rrezikshme, burimet kryesore të ndotjes janë pluhuri, zhurma, emetimet nga automjetet, rrjedhjet aksidentale të vajrave/karburanteve dhe shpërndarja e materialeve të imta gjatë manipulimit.

6.13. Trajtimin e mbeturinave

Mbeturinat që krijohen në kompani janë kryesisht mbeturina komunale nga personeli dhe administrata, si ambalazhe ushqimore, shishe plastike, letër/karton, qese plastike dhe mbetje higjienike. Këto grumbullohen në kontejnerë të veçantë dhe të mbyllur, vendosen në hapësirë të caktuar për mbledhje dhe dorëzohen rregullisht te shërbimi komunal ose te operatorë të autorizuar për grumbullim dhe trajtim, sipas marrëveshjes/kontratës përkatëse.

6.14. Infrastruktura rrugore dhe qasja

Lokacioni ka qasje përmes rrjetit ekzistues rrugor në gjendje të mirë, i cili siguron hyrje dhe dalje të sigurt për mjetet transportuese.

6.15. Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit

Në nivel organizativ, kompania cakton person përgjegjës për mjedisin, i cili koordinon zbatimin e masave mjedisore, mbikëqyr procedurat e menaxhimit të mbeturinave, kujdeset për evidencat dhe dokumentacionin, si dhe siguron komunikim me autoritetet kompetente kur kërkohet. Përgjegjësia për zbatimin praktik të masave ndahet edhe me udhëheqësin operativ të lokacionit dhe me personelin që punon në pranimin, seleksionimin dhe magazinimin, ku secili ka detyrime të përcaktuara për rend, pastërti, siguri dhe shmangie të veprimeve që mund të shkaktojnë ndotje. Procedurat kryesore për menaxhimin e mjedisit përfshijnë kontrollin e pranimit të mbeturinave, ku pranohen vetëm mbeturina të lejuara sipas Katalogut Shtetëror dhe kushteve

të autorizimit, si dhe kryhet kontroll vizual për të identifikuar materiale të paautorizuara. Parashihet peshimi dhe regjistrimi i çdo ngarkese hyrëse dhe dalëse, me qëllim gjurmueshmërinë e sasive dhe kontrollin e stokut.

6.16. Trajnimi

Stafi trajnohet për sigurinë në punë, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen mjedisore dhe reagimin në raste emergjente.

6.17. Monitorimi

Monitorimi gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit, zbatohet për të siguruar që aktiviteti zhvillohet në përputhje me kërkesat ligjore, masat e përcaktuara në VNM dhe procedurat e brendshme të kompanisë. Qëllimi i monitorimit është identifikimi me kohë i çdo parregullsie, parandalimi i ndotjes dhe mbajtja nën kontroll e ndikimeve të mundshme në ajër, tokë dhe ujë, si dhe garantimi i sigurisë operative..

6.18. Planet për situata emergjente

Janë paraparë plane për reagim në raste zjarri, aksidente pune, derdhje të mundshme të materialeve dhe defekte teknike, me pajisje dhe procedura të përcaktuara.

6.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Demolimi dhe rehabilitimi lidhen me fazën e mbylljes së aktivitetit të Qendrës së Grumbullimit të “2T COMPANY” SH.P.K., ose me rastet kur ndërpritet operimi, ndryshohet destinimi i lokacionit apo kërkohet largimi i infrastrukturës ekzistuese. Qëllimi i kësaj faze është që lokacioni të lirohet nga mbeturinat dhe pajisjet, të shmanget çdo rrezik i ndotjes së tokës dhe ujërave, dhe hapësira të kthehet në gjendje të sigurt dhe të qëndrueshme për përdorim të mëtejshëm.

6.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Plani përfshin masa parandaluese, monitoruese dhe korrigjuese për minimizimin e ndikimeve mjedisore gjatë gjithë periudhës së funksionimit.

6.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim

Alternativa pa veprim nënkupton mosoperimin e qendrës. Kjo alternativa “pa veprim” do të eliminonte ndikimet lokale të operimit në lokacion, por do të krijonte boshllëk në menaxhimin e kontrolluar të mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera jo të rrezikshme, duke rritur rrezikun që këto mbeturina të mos trajtohen në mënyrë të organizuar dhe të gjurmueshme. Për këtë arsye, në aspektin mjedisor dhe praktik, kjo alternativë konsiderohet më pak e favorshme krahasuar me realizimin e projektit me zbatimin e masave mbrojtëse të parashikuara..

7. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

Funksionimi i Qendrës së Grumbullimit të “2T COMPANY” SH.P.K. në Caravodicë, Komuna e Obiliqit, përfshin pranimin, peshimin, seleksionimin, ruajtjen e përkohshme dhe trajtimin fillestar të mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera jo të rrezikshme, me qëllim dërgimin e tyre për riciklim ose trajtim të mëtejshëm të operatorëve të licencuar. Për shkak të natyrës së aktivitetit, ndikimet mjedisore janë kryesisht të karakterit lokal dhe të menaxhueshme, dhe lidhen me pluhurin, zhurmën, trafikun, rrezikun e rrjedhjeve aksidentale dhe organizimin e ruajtjes së materialeve në lokacion.

Analiza e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është realizuar duke u bazuar në dokumentacionin teknik të projektit, karakteristikat fizike dhe mjedisore të lokacionit, gjendjen ekzistuese të zonës dhe praktikën e mira për menaxhimin e mbeturinave. Ndikimet e projektit janë analizuar në raport me këto aspekte kryesore të mjedisit:

- Aspektet fizike dhe kimike, të cilat përfshijnë ndikimet e mundshme në ajër (pluhur), tokë, ujë dhe zhurmë, si dhe menaxhimin e mbeturinave dhe materialeve gjatë funksionimit;
- Aspektet biologjike dhe ekologjike, që lidhen me ndikimet e mundshme në florë, faunë dhe mjedisin përreth, duke marrë parasysh se zona përreth ka karakter industrial dhe nuk përfshin zona të mbrojtura apo habitate me vlera të veçanta ekologjike;
- Aspektet socio-ekonomike, të cilat përfshijnë ndikimet në komunitetin lokal, punësimin, qarkullimin e mjeteve dhe kontributin e projektit në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë fazës së funksionimit, projekti nuk përfshin procese djegieje, nuk përdor substanca kimike të rrezikshme dhe nuk gjeneron ujëra të ndotura teknologjike. Ndikimet e mundshme janë të kufizuara, të lokalizuara dhe të menaxhueshme përmes zbatimit të masave teknike dhe organizative, si kontrolli i pluhurit, zhurmës, menaxhimi i rregullt i mbeturinave dhe respektimi i standardeve të sigurisë. Qëllimi kryesor i këtij vlerësimi është të sigurojë që projekti të funksionojë në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe duke kontribuar pozitivisht në reduktimin e mbeturinave dhe rritjen e shkallës së riciklimit.

7.1. Ndikimet në ajër

Gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, ndikimet në ajër janë të karakterit lokal dhe me intensitet të ulët. Burimet kryesore potenciale të ndotjes së ajrit lidhen me gjenerimin e

pluhurit gjatë pranimit, manipulimit, seleksionimit dhe copëtimit mekanik të mbeturinave metalike si dhe mebtuarnave tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, si dhe me emetimet nga mjetet motorike që përdoren për transportin e mbeturinave dhe lëvizjen brenda lokacionit. Mjetet motorike që përdoren në kuadër të aktivitetit çlirojnë gazra të djegies së karburanteve fosile, kryesisht dioksid karboni (CO₂), monoksid karboni (CO), okside të azotit (NO_x), dioksid squfuri (SO₂) dhe grimca të pezulluara (PM₁₀ dhe PM_{2.5}). Këto emetime janë të kufizuara në kohë dhe hapësirë. Projekti nuk përfshin procese djegieje industriale, trajtime termike apo përdorim të substancave kimike të rrezikshme, prandaj nuk gjeneron emetime të drejtpërdrejta industriale në ajër. Ndikimet e mundshme nga pluhuri dhe gazrat e automjeteve konsiderohen të menaxhueshme përmes zbatimit të masave teknike dhe organizative. Në përfundim, ndikimet në ajër nga operimi i qendrës priten të jenë lokale dhe të intensitetit të ulët, por për shkak të ngarkesës ekzistuese të ajrit nga zona industriale dhe afërsia me Termocentralin “Kosova A”, zbatimi i masave për kontroll të pluhurit dhe emetimeve është i domosdoshëm, me qëllim që kontributi shtesë i projektit të jetë minimal dhe i menaxhueshëm.

7.2.Ndikimet në tokë

Gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, ndikimet në tokë parashikohen të jenë të kufizuara dhe të menaxhueshme. Aktiviteti zhvillohet në një oborr të betonuar, pa punime gërmuese apo ndryshime të relievit, çka redukton ndjeshëm rrezikun e degradimit dhe ndotjes së tokës. Ndikimet e mundshme në tokë lidhen kryesisht me rrezikun e ndotjes aksidentale nga rrjedhjet e vajrave, karburanteve ose lëngjeve teknike nga mjetet dhe pajisjet, si dhe nga depozitimi i përkohshëm i mbeturinave. Megjithatë, projekti nuk përfshin përdorimin e substancave kimike të rrezikshme dhe nuk gjeneron mbetje të lëngshme teknologjike. Duke qenë se manipulimi i mbeturinave realizohet në sipërfaqe të përcaktuara dhe të kontrolluara, ndikimet potenciale në tokë konsiderohen lokale, të përkohshme dhe të parandalueshme përmes zbatimit të masave teknike dhe organizative. Në përgjithësi, nuk pritet degradim i qëndrueshëm i tokës apo humbje e funksionit të saj mjedisor.

7.3.Ndikimet në ujë

Gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, ndikimet në ujë parashikohen të jenë minimale dhe të kontrollueshme. Projekti nuk përfshin procese teknologjike që gjenerojnë ujëra të ndotura industriale dhe nuk ka shkarkime direkte në ujërat sipërfaqësore apo nëntokësore. Ujërat e shiut kalojnë përmes reshtkave deri tek gropa septike. Furnizimi me ujë realizohet nga

rrjeti publik i ujësjellësit, ndërsa ujërat sanitare menaxhohen përmes sistemit ekzistues të kanalizimit me gropë septike dhe ndarës të vajrave.



Figura 12. Gropa septike dhe ndarësi i vajrave

Ndikimet e mundshme në ujë mund të lidhen vetëm me rrezikun e derdhjeve aksidentale të vajrave ose karburanteve nga mjetet dhe pajisjet, të cilat, duke qenë se aktiviteti zhvillohet në sipërfaqe të betonuara dhe të kontrolluara, konsiderohen të parandalueshme. Duke marrë parasysh masat e menaxhimit të ujërave dhe mungesën e proceseve ndotëse, nuk pritet ndotje e ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore, përfshirë lumin Sitnica, dhe ndikimet në komponentin ujë vlerësohen si të vogla dhe pa ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedis.

7.4. Ndikimi në peizazh

Projekti i Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave realizohet në një lokacion ekzistues ku peizazhi tashmë është i modifikuar nga aktivitetet industriale dhe infrastruktura përreth. Për këtë arsye, ndikimi i projektit në peizazh vlerësohet si i vogël dhe i kufizuar. Aktivitetet e planifikuara zhvillohen brenda kufijve të parcelës ekzistuese, pa ndërtime të reja dhe pa ndryshime të relievit apo të strukturës hapësinore të zonës. Pajisjet dhe materialet operative janë tipike për veprimtari industriale dhe nuk pritet të shkaktojnë ndryshime të dukshme vizuale në krahasim me gjendjen aktuale të lokacionit. Duke marrë parasysh zonën dhe mungesën e elementeve me vlera të veçanta estetike apo peizazhore në afërsi të drejtpërdrejtë, ndikimi në peizazh konsiderohet i përkohshëm, lokal dhe pa ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedisin përreth.

7.5.Ndikimi në florë dhe faunë

Projekti i Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, zona e projektit nuk përfshin habitate natyrore të ruajtura, zona të mbrojtura apo ekosisteme me vlera të veçanta ekologjike. Aktivitetet e planifikuara, përfshirë grumbullimin, seleksionimin dhe copëtimin e mbeturinave metalike, dhe mbeturinave të tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, zhvillohen brenda një hapësire të betonuar dhe të kontrolluar. Për këtë arsye, nuk parashikohet shkatërrim i vegjetacionit, fragmentim i habitateve apo ndërhyrje direkte në faunën lokale. Ndikimet e mundshme në florë dhe faunë mund të lidhen vetëm në mënyrë indirekte me zhurmën dhe lëvizjen e mjeteve, të cilat janë të kufizuara dhe të zakonshme. Duke marrë parasysh karakterin e lokacionit dhe masat e menaxhimit të parashikuara, ndikimi i projektit në florë dhe faunë vlerësohet si i vogël dhe pa ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedisin përreth.

7.6.Ndikimi në nivelet e zhurmës

Gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, ndikimet në nivelet e zhurmës parashikohen të jenë të kufizuara dhe kryesisht lokale. Burimet kryesore të zhurmës lidhen me funksionimin e pajisjeve mekanike për seleksionim dhe copëtim të mbeturinave metalike dhe mbeturinave tjera, si dhe me lëvizjen e mjeteve transportuese gjatë pranimin dhe largimit të mbeturinave. Aktivitetet zhvillohen në një zonë me karakter industrial dhe në një oborr të betonuar, larg zonave të ndjeshme të banuara. Zhurma e gjeneruar është e përkohshme, e ndërprerë dhe tipike për veprimtari të këtij lloji. Nuk parashikohen burime të vazhdueshme apo intensive të zhurmës që do të tejkalojnë kufijtë e lejuar ligjorë. Duke marrë parasysh karakterin e lokacionit, orarin e punës dhe masat e menaxhimit të parashikuara, ndikimi në nivelet e zhurmës vlerësohet si i vogël dhe pa ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedisin përreth dhe shëndetin e njeriut.

7.7.Ndikimi social gjatë fazë së ndërtimit, operimit dhe demolimit

Projekti i Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave ka ndikim kryesisht pozitiv nga aspekti social. Aktiviteti zhvillohet në një zonë ekzistuese me karakter industrial, larg zonave të ndjeshme të banuara, prandaj nuk pritet të shkaktojë ndikime negative të drejtpërdrejta në jetën e përditshme të komunitetit lokal. Nga aspekti socio-ekonomik, projekti kontribuon në krijimin dhe ruajtjen e vendeve të punës, rritjen e aktivitetit ekonomik lokal dhe përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave. Funksionimi i qendrës ndihmon në uljen e sasisë së mbeturinave të hedhura në mënyrë të pakontrolluar dhe kontribuon në rritjen e shkallës së riciklimit, duke ndikuar

pozitivisht në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik. Ndikimet e mundshme negative sociale mund të lidhen me rritjen e kufizuar të lëvizjes së mjeteve transportuese dhe zhurmën gjatë orarit të punës, por këto ndikime janë të vogla, të përkohshme dhe të menaxhueshme përmes masave organizative dhe respektimit të orareve të punës. Në përgjithësi, ndikimi social i projektit vlerësohet si pozitiv, pasi kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm lokal, rritjen e ndërgjegjësimit për menaxhimin e mbeturinave dhe përmirësimin e kushteve mjedisore për komunitetin përreth.

7.8.Ndikimi nga Mbeturinat

Duke qenë se projekti ka për qëllim menaxhimin e kontrolluar të mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera jo të rrezikshme, ndikimi potencial negativ lidhet kryesisht me mënyrën e ruajtjes së përkohshme, rrezikun e përzierjes së fraksioneve, shpërndarjen e materialeve të imta, krijimin e rrëmujës në lokacion dhe mundësinë e ndotjes së tokës dhe ujërave në rast të rrjedhjeve aksidentale.

Mbeturinat hyrëse, nëse nuk menaxhohen si duhet, mund të shkaktojnë ndikime si shpërndarja e materialeve nga era, mbetje të vogla metalike në sipërfaqe, rritje të pluhurit gjatë manipulimit dhe ndikim vizual nga grumbuj të pa sistemuar. Për këtë arsye, ndikimi nga mbeturinat minimizohet përmes pranimit vetëm të kodeve të lejuara, seleksionimit dhe ndarjes sipas fraksioneve, ruajtjes së organizuar në zona të dedikuara dhe mbajtjes së lokacionit në rend dhe pastërti të vazhdueshme. Ruajtja e kontrolluar dhe grumbullimi në sasi të menaxhueshme redukton rrezikun e tejngarkimit të hapësirës dhe krijimit të pikave të ndotjes.

Gjatë seleksionimit mund të dalin sasi të vogla të mbetjeve të papërshtatshme ose të përziera, të cilat nuk kanë vlerë për riciklim ose nuk plotësojnë kriteret e pranimit. Këto, nëse lihen pa trajtim, mund të krijojnë ndikim negativ në mjedis. Prandaj ato izoloohen, grumbullohen veçmas dhe dërgohen për trajtim të mëtejshëm ose depozitim në lejuar te operatorë të licencuar. Mbeturinat komunale të krijuara nga personeli grumbullohen në kontejnerë të veçantë dhe dorëzohen rregullisht te shërbimi komunal ose operatorë të autorizuar.

8. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

Bazuar në analizën e kryer mbi ndikimet mjedisore të projektit për funksionimin e Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, si dhe duke u mbështetur në dokumentacionin teknik dhe vlerësimet e paraqitura në këtë raport, vlerësohet se aktiviteti i planifikuar i kompanisë nuk paraqet rrezik të konsiderueshëm për mjedisin jetësor, për aq kohë sa zbatohen masat mbrojtëse të parashikuara. Proceset zhvillohen në kushte të kontrolluara dhe nuk përfshijnë procese djegieje, përdorim të substancave kimike të rrezikshme apo gjenerim të ujërave të ndotura teknologjike. Ndikimet e mundshme mjedisore lidhen kryesisht me gjenerimin e pluhurit, zhurmës dhe rrezikun e ndotjeve aksidentale nga mjetet dhe pajisjet, por këto ndikime janë të kufizuara, lokale dhe të menaxhueshme përmes zbatimit të masave teknike dhe organizative përkatëse. Masat për mbrojtjen e mjedisit do të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës së funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, gjatë ndërprerjes së aktivitetit. Zbatimi i masave mbrojtëse synon parandalimin, reduktimin ose eliminimin e çdo ndikimi të mundshëm negativ në ajër, tokë, ujë, peizazh, florë, faunë dhe shëndetin e njeriut, duke respektuar vlerat kufitare të lejuara ligjore për zhurmën, emetimet dhe menaxhimin e mbeturinave. Për të garantuar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, operatori i projektit është i obliguar të zbatojë praktika të mira të menaxhimit mjedisor dhe sigurisë në punë, përfshirë mirëmbajtjen e rregullt të pajisjeve, monitorimin e aktiviteteve dhe zbatimin e procedurave të qarta për reagim në situata emergjente. Këto masa sigurojnë funksionim të qëndrueshëm, të sigurt dhe mjedisorisht të përgjegjshëm të Qendrës së Grumbullimit gjatë gjithë periudhës së operimit, në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

8.1.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të zvogëluar dhe kontrolluar ndikimet e mundshme në ajër gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, do të zbatohen masat e mëposhtme:

- Pastrimi dhe mirëmbajtja e rregullt e sipërfaqeve operative dhe rrugëve të brendshme për të parandaluar përhapjen e pluhurit, parashihet menaxhim i rregullt i trafikut brenda lokacionit, me kufizim të shpejtësisë së automjeteve.
- Sipërfaqet operative mbahen të pastra dhe pastrohen rregullisht për të ulur pluhurin,
- Sperkatja periodike e zonave ku ka lëvizje të shtuar të mjeteve dhe manipulim të mbeturinave, sidomos gjatë periudhave të thata.

- Mbeturinat sistemohen në mënyrë të kontrolluar për të shmangur shpërndarjen nga era.
- Mirëmbajtja e rregullt teknike e mjeteve motorike dhe pajisjeve për të siguruar funksionim efikas dhe reduktim të emetimeve të gazeve ndotëse (CO₂, CO, NO_x, SO₂).
- Organizimi i proceseve të seleksionimit dhe copëtimit në mënyrë që të minimizohet gjenerimi i pluhurit.
- Pajisja e punëtorëve me mjete mbrojtëse personale (maskë kundër pluhurit), sipas nevojës.

Zbatimi i këtyre masave do të sigurojë që ndikimet në cilësinë e ajrit të mbahen brenda kufijve të lejuar dhe të mos shkaktjnë ndikime të konsiderueshme negative në mjedisin përreth dhe shëndetin e njeriut.

8.2.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet e mundshme në ujë gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, do të zbatohen masat e mëposhtme:

- Lokacioni mbahet i pastër për të mos lejuar që reshjet të bartin papastërti.
- Menaxhimi i ujërave sanitare përmes gropës septike ekzistuese me ndarës të vajrave, në përputhje me kërkesat ligjore.
- Mirëmbajtja e rregullt e gropës septike dhe ndarësit të vajrave për të siguruar funksionim të sigurt dhe pa rrjedhje.
- Parandalimi i derdhjeve aksidentale të vajrave dhe karburanteve përmes mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve.
- Vendosija e materialeve absorbuese dhe pajisjeve për ndërhyrje të shpejtë në rast të derdhjeve aksidentale..

Zbatimi i këtyre masave do të sigurojë mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe do të parandalojë çdo ndikim negativ në mjedis.

8.3.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet e mundshme në tokë gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, do të zbatohen këto masa:

- Mbeturinat ruhen vetëm në zona të përcaktuara dhe në mënyrë të organizuar sipas llojit të mbeturës.

- Zhvillimi i aktivitetit vetëm në sipërfaqe të betonuar dhe të përcaktuara për manipulimin dhe depozitimin e mbeturinave.
- Mirëmbajtja e rregullt e mjeteve dhe pajisjeve për të parandaluar rrjedhjet e vajrave, karburanteve dhe lëngjeve teknike.
- Vendorsja e materialeve absorbuese dhe pajisjeve për ndërhyrje të shpejtë në rast të derdhjeve aksidentale.
- Grumbullimi dhe ruajtja e përkohshme e mbeturinave në zona të dedikuara dhe të kontrolluara.
- Ndalimi i hedhjes së mbeturinave apo lëngjeve teknike jashtë zonave të përcaktuara
- Trajnimi i stafit për menaxhimin korrekt të mbeturinave dhe reagimin në raste të ndotjes aksidentale.

Zbatimi i këtyre masave do të sigurojë mbrojtjen e tokës dhe parandalimin e çdo ndikimi negativ afatgjatë në mjedis.

8.4.Masat për mbrojtje nga zhurma

Për të zvogëluar dhe kontrolluar ndikimet nga zhurma gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, do të zbatohen masat e mëposhtme:

- Operimi i qendrës brenda orarit të lejuar.
- Mirëmbajtjen e pajisjeve dhe organizimin e punëve në mënyrë që të shmanget zhurma e panevojshme.
- Manipulimi i materialeve metalike bëhet në mënyrë të kontrolluar për të ulur goditjet dhe zhurmën impulsive.
- Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive në gjendje të mirë teknike, me mirëmbajtje të rregullt, për të shmangur zhurmat e panevojshme.
- Kufizimi i shpejtësisë së mjeteve transportuese brenda lokacionit për reduktimin e zhurmës nga trafiku i brendshëm.
- Pajisja e punëtorëve me mjete mbrojtëse personale kundër zhurmës, sipas nevojës.

Zbatimi i këtyre masave do të sigurojë që nivelet e zhurmës të mbahen brenda kufijve të lejuar dhe të mos shkaktojnë ndikime të konsiderueshme negative në mjedisin përreth.

8.5.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh

Për të zvogëluar dhe kontrolluar ndikimet në peizazh gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, do të zbatohen masat e mëposhtme:

- Mbeturinat do të ruhen vetëm në zona të dedikuara dhe të ndara sipas kategorive, me sistemim të rregullt në kontejnerë ose grumbuj me lartësi të kontrolluar.
- Materialet që mund të shpërndahen nga era do të mbahen të sigurta dhe, kur është e nevojshme, të mbuluara ose në kontejnerë të mbyllur.
- Do të zbatohet pastrim i vazhdueshëm i oborrit dhe largim i menjëhershëm i mbetjeve të shpërndara.
- Pajisjet dhe kontejnerët do të mbahen në gjendje të mirë dhe do të vendoset sinjalistikë e qartë për zonat e punës, në mënyrë që hapësira të duket e menaxhuar dhe me ndikim sa më të ulët vizual.

Zbatimi i këtyre masave siguron që ndikimi i aktivitetit në peizazh të mbetet minimal dhe në përputhje me karakterin industrial të zonës.

8.6.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në florë dhe faunë

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet e mundshme në florë dhe faunë gjatë funksionimit të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, do të zbatohen masat e mëposhtme:

- Zhvillimi i të gjitha aktiviteteve brenda kufijve të parcelës ekzistuese të betonuar, pa ndërhyrje në sipërfaqe natyrore apo zona të gjelbëruara.
- Organizimi i rregullt i zonave operative për grumbullimin, seleksionimin dhe copëtimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera, për të shmangur përhapjen jashtë zonave të përcaktuara.
- Kufizimi i zhurmës dhe lëvizjes së panevojshme të mjeteve, veçanërisht gjatë orëve të ndjeshme, për të shmangur shqetësimin e faunës përreth.
- Menaxhimi korrekt i mbeturinave dhe parandalimi i derdhjeve aksidentale që mund të ndikojnë indirekt në ekosistemet përreth.
- Mirëmbajtja e rregullt e lokacionit për të shmangur krijimin e kushteve të pafavorshme për florën dhe faunën lokale.

Zbatimi i këtyre masave siguron që ndikimet e projektit në florë dhe faunë të mbeten minimale dhe në përputhje me karakterin industrial të zonës.

9. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

9.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis ka për qëllim sigurimin e kontrollit të vazhdueshëm të aktiviteteve të Qendrës së Grumbullimit të Mbeturinave Metalike dhe Mbeturinave të Tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, si dhe verifikimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore në fuqi. Monitorimi synon identifikimin në kohë të çdo ndikimi të mundshëm negativ në mjedis dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese përkatëse në rast se paraqiten devijime nga kushtet e lejuara. Duke qenë se projekti zhvillohet në një lokacion ekzistues dhe nuk përfshin fazë ndërtimi, monitorimi do të realizohet kryesisht gjatë fazës së operimit dhe, sipas nevojës, gjatë ndërprerjes ose përfundimit të aktivitetit. Programi i monitorimit do të përqendrohet në parametrat që lidhen drejtpërdrejt me natyrën e aktivitetit të qendrës, përfshirë: cilësinë e ajrit (pluhur dhe emetime nga mjetet), nivelet e zhurmës, gjendjen e tokës, menaxhimin e ujërave sanitare, menaxhimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, si dhe respektimin e masave mbrojtëse të parashikuara në këtë raport. Zbatimi i këtij programi do të sigurojë funksionim të kontrolluar dhe mjedisorisht të përgjegjshëm të qendrës, duke garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9.2. Gjendja mjedisore para fillimit të projektit

Lokacioni i projektit ndodhet në një zonë me karakter industrial në Komunën e Obiliqit, e cila është e ngarkuar me ndotje mjedisore për shkak të afërsisë me Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”. Gjithashtu, në afërsi ndodhen edhe deponia e mbeturinave komunale dhe deponitë/zonat e depozitimit të qymyrit, të cilat kontribuojnë në gjendjen ekzistuese të mjedisit, sidomos përmes pluhurit, erërave të pakëndshme dhe ndikimeve vizuale.

Në aspektin e cilësisë së ajrit, zona karakterizohet nga prani e shtuar e pluhurit dhe grimcave të imta, veçanërisht gjatë periudhave të thata dhe me erë, si pasojë e aktiviteteve industriale, deponive dhe trafikut të rëndë. Burimet kryesore që ndikojnë në sfondin e ndotjes janë emetimet industriale nga termocentralet, si dhe shpërndarja e pluhurit nga zonat e qymyrit dhe deponitë përreth.

Gjendja e tokës në zonë mund të jetë e ndikuar nga depozitimet historike të pluhurit industrial, nga prania e materialeve të imta të bartura nga era, si dhe nga aktivitetet industriale dhe deponitë afër. Në disa zona ekziston potencial për ndotje sipërfaqësore, sidomos në hapësira ku ka lëvizje të shpeshtë të automjeteve të rënda dhe ku mund të ndodhin shpërndarje materiale.

Në aspektin e ujërave, zona mund të ndikohet nga rrjedhat sipërfaqësore gjatë reshjeve, të cilat bartin papastërti nga sipërfaqet e ekspozuara industriale dhe deponitë. Edhe pse projekti nuk gjeneron ujëra teknologjike, gjendja ekzistuese kërkon kujdes të shtuar për menaxhimin e oborrit dhe parandalimin e rrjedhjeve aksidentale, në mënyrë që të mos shtohet ngarkesa e ndotjes.

Sa i përket zhurmës, zona është e ekspozuar ndaj niveleve më të larta të zhurmës për shkak të operimeve industriale dhe qarkullimit të automjeteve të rënda. Ndikimi vizual është gjithashtu i pranishëm, për shkak të pranisë së termocentraleve, deponive dhe aktiviteteve të tjera industriale në afërsi.

Në përfundim, gjendja mjedisore para fillimit të projektit konsiderohet e ndikuar paraprakisht nga burime të mëdha industriale, termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, si dhe nga afërsia me deponinë e mbeturinave dhe zonat e qymyrit. Për këtë arsye, gjatë operimit të projektit duhet të zbatohen masa të rrepta për kontrollin e pluhurit, ruajtjen e rendit, parandalimin e ndotjes së tokës dhe ujërave, në mënyrë që kontributi shtesë i projektit të jetë minimal.

9.3. Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis

Efektet e dëmshme në mjedis nga funksionimi i qendrës mund të përcaktohen përmes parametrave kryesorë që lidhen me ajrin, tokën, ujërat, zhurmën, menaxhimin e mbeturinave dhe sigurinë operative.

Për ajrin, parametrat kryesorë janë prania e pluhurit dhe grimcave të imta gjatë lëvizjes së automjeteve dhe manipulimit të materialeve, si dhe emetimet nga automjetet, që vlerësohen përmes tymit të dukshëm dhe gjendjes teknike të mjeteve.

Për tokën, përcaktohen shenjat e ndotjes sipërfaqësore si njolla vajrash/karburantesh, shpërndarja e mbetjeve në sipërfaqe dhe niveli i pastërtisë në zonat operative.

Për ujërat, parametrat lidhen me prani të ndotjes së dukshme në rrjedhat sipërfaqësore gjatë reshjeve, ndryshim ngjyre, erë të pazakontë dhe shenja të bartjes së papastërtive nga oborri.

Për zhurmën, parametrat janë niveli dhe kohëzgjatja e zhurmës gjatë shkarkimit/ngarkimit dhe trafikut, respektimi i orareve të punës dhe ankesat e mundshme nga rrethina.

Për menaxhimin e mbeturinave, parametrat përfshijnë sasinë e pranuar dhe të dërguara sipas kodeve, mënyrën e ruajtjes së përkohshme (ndarja sipas fraksioneve, rendi, stok i kontrolluar), sasinë e mbetjeve të papërshtatshme dhe evidencat/dokumentacionin shoqërues.

Për sigurinë dhe kontrollin, parametra të rëndësishëm janë numri i incidenteve, rrjedhjeve aksidentale, koha e reagimit, rezultatet e inspektimeve të brendshme dhe zbatimi i procedurave dhe masave mbrojtëse.

9.4.Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar

Matjet do të realizohen brenda lokacionit të projektit dhe, sipas nevojës, në zonën përreth tij. Monitorimi do të kryhet në mënyrë periodike gjatë fazës së operimit, me shpeshtësi të përshtatur sipas natyrës së aktivitetit dhe kërkesave ligjore. Matjet do të realizohen përmes pajisjeve të certifikuara dhe, kur kërkohet, nga subjekte të autorizuar.

9.5.Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera

Raportet e monitorimit do të përfshijnë rezultatet e matjeve, analizën dhe krahasimin e tyre me vlerat kufitare të lejuara, si dhe rekomandimet për masa korrigjuese nëse identifikohen devijime. Raportimi do të bëhet në baza periodike dhe do t’u dorëzohet autoriteteve kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9.6.Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Zbatuesi i projektit është i obliguar të sigurojë transparencë dhe të informojë publikun për rezultatet e monitorimit mjedisor, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Informimi do të realizohet përmes raporteve zyrtare dhe, sipas nevojës, përmes njoftimeve publike nga institucionet kompetente.

9.7.Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis

Duke marrë parasysh natyrën, shtrirjen dhe karakterin lokal të projektit, nuk parashikohen ndikime ndërkufitare në mjedis. Për rrjedhojë, nuk kërkohet zbatimi i një programi ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis. Në rast të ndryshimeve të paparashikuara, autoritetet kompetente do të njoftohen në përputhje me procedurat ligjore.

10. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

11. Plani i Menaxhimit Mjedisor për funksionimin e Qendrës së Grumbullimit të “2T COMPANY” SH.P.K. në Caravodicë, Komuna e Obiliqit, përcakton masat, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen gjatë aktivitetit, me qëllim parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndikimeve në mjedis. Plani mbështetet në pranim të kontrolluar të mbeturinave, menaxhim të rregullt të operimeve, evidencë dhe monitorim, si dhe reagim të menjëhershëm në rast të parregullsive. Duke qenë se lokacioni ndodhet në zonë industriale të ndikuar nga burime të mëdha ndotjeje, zbatimi i masave është i domosdoshëm për të siguruar që kontributi shtesë i projektit të jetë minimal dhe i menaxhueshëm.

11.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Mbrojtja efektive mjedisore sigurohet duke zbatuar masa të vazhdueshme organizative dhe teknike në çdo fazë të aktivitetit, nga pranimi dhe peshimi i mbeturinave, te seleksionimi, ruajtja e përkohshme, ngarkimi dhe dërgimi për riciklim, si dhe në rast të ndërprerjes së operimit. Gjatë operimit pranohen vetëm mbeturina të lejuara sipas Katalogut Shtetëror, me kontroll vizual dhe me peshim e regjistrim për gjurmueshmëri. Mbeturinat ndahen sipas llojit dhe ruhen në zona të dedikuara me stok të kontrolluar, ndërsa lokacioni mbahet i pastër me pastrim të rregullt dhe organizim të qarkullimit të automjeteve për uljen e pluhurit dhe zhurmës. Pajisjet dhe automjetet mirëmbahen për të reduktuar emetimet dhe për të parandaluar rrjedhjet. Për mbrojtjen e tokës dhe ujërave zbatohen masa për parandalimin e derdhjeve aksidentale, duke siguruar materiale absorbente dhe procedura reagimi, ndërsa çdo incident trajtohet menjëherë me izolim, pastrim dhe dokumentim. Ujërat teknologjike nuk gjenerohen, por menaxhimi i oborrit dhe kontrolli i ujërave atmosferike mbeten pjesë e përditshme e punës. Mbeturinat komunale të krijuara në kompani dhe mbetjet e papërshtatshme nga seleksionimi grumbullohen veçmas dhe dorëzohen te shërbimi komunal ose operatorë të autorizuar. Transporti kryhet vetëm drejt operatorëve të licencuar, me ngarkim të sigurt dhe dokumentacion shoqërues.

Në rast të ndërprerjes së aktivitetit, parashihet largimi i plotë i të gjitha mbeturinave nga lokacioni, pastrimi i zonave operative dhe rehabilitimi i sipërfaqeve, në mënyrë që të mos mbetet asnjë burim ndotjeje. Gjatë gjithë fazave sigurohen përgjegjësi të qarta, trajnime për personelin, monitorim i rregullt dhe evidenca të plota për hyrje daljet, dorëzimet, pastrimet, mirëmbajtjen dhe incidentet, duke garantuar përputhje me kërkesat ligjore dhe mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit publik.

11.2. Pajrushmeria me pëlqim mjedisor

Zbatimi dhe funksionimi i projektit do të realizohen në përputhje të plotë me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pëlqimin dhe lejen mjedisore, si dhe me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi për menaxhimin e mbeturinave. Kompania është përgjegjëse për:

- zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore të parashikuara në këtë raport;
- monitorimin e rregullt të ndikimeve mjedisore;
- menaxhimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave;
- raportimin periodik ndaj institucioneve kompetente;
- bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse.

Çdo ndryshim eventual në aktivitet, kapacitet apo teknologji do të trajtohet në përputhje me procedurat ligjore përkatëse.

11.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore, kompania synon zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me parimet e standardit ISO 14000. Zbatimi i këtij sistemi do të kontribuojë në:

- identifikimin dhe kontrollin sistematik të ndikimeve mjedisore;
- përmirësimin e efikasitetit operativ në menaxhimin e mbeturinave;
- rritjen e ndërgjegjësisë dhe përgjegjësisë mjedisore të stafit;
- përmbushjen e vazhdueshme të kërkesave ligjore dhe institucionale.

Zhvillimi i sistemit të menaxhimit mjedisor do të realizohet në mënyrë graduale, në përputhje me natyrën dhe shkallën e aktivitetit të Qendrës së Grumbullimit.

12. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT

12.1. Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,

NPër përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së Raportit të VNM-së për “2T COMPANY” SH.P.K., merren parasysh karakteristikat kryesore të projektit që lidhen me natyrën e aktivitetit, llojet e mbeturinave, mënyrën e operimit dhe ndjeshmërinë mjedisore të zonës ku zhvillohet aktiviteti. Projekti ka të bëjë me funksionimin e një qendre ekzistuese për pranimin, peshimin, seleksionimin, ruajtjen e përkohshme dhe trajtimin fillestar të mbeturinave metalike dhe mbeturinave të tjera jo të rrezikshme, të cilat më pas dërgohen për riciklim ose trajtim të mëtejshëm te operatorë të licencuar.

Karakteristikë e rëndësishme e projektit është se proceset në lokacion janë kryesisht fizike dhe mekanike, pa trajtime kimike dhe pa asgjësim final në vend. Kjo e orienton raportin e VNM-së në vlerësimin e ndikimeve lokale që lidhen me pluhurin, zhurmën, trafikun, ruajtjen e përkohshme, rrezikun e rrjedhjeve aksidentale dhe menaxhimin e mbetjeve dytësore nga aktiviteti. Po ashtu, përmbajtja e raportit përcaktohet edhe nga fakti që qendra pranon vetëm mbeturina të listuara në Katalogun Shtetëror të Mbeturinave dhe në përputhje me kushtet ligjore dhe autorizimet përkatëse, çka kërkon përfshirjen e një përkrahjeje të qartë të kodeve dhe rrjedhës së mbeturinave.

Lokacioni i projektit ndodhet në zonë industriale të Komunës së Obiliqit, afër burimeve të mëdha të ndotjes si Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, si dhe pranë deponive të mbeturinave dhe zonave të depozitimit të qymyrit. Kjo gjendje ekzistuese ndikon në qëllimin e raportit, pasi kërkohet që vlerësimi të marrë parasysh sfondin mjedisor të ndotur dhe të demonstrojë se projekti nuk do të kontribuojë në mënyrë të ndjeshme në rritjen e ndotjes, përmes zbatimit të masave të kontrollit dhe menaxhimit të rregullt.

Informacionet shitesë që përcaktojnë qëllimin dhe përmbajtjen e raportit përfshijnë kapacitetet operative të qendrës, mënyrën e organizimit të hapësirave (hyrje, peshore, zona e shkarkimit, seleksionimi, magazinimi, ngarkimi), pajisjet dhe mekanizimin e përdorur, numrin dhe rolin e personelit, si dhe mënyrën e transportit dhe destinacionin e mbeturinave te operatorë të licencuar. Gjithashtu, raporti përfshin masat parandaluese për kontrollin e pluhurit, zhurmës, ndotjes së tokës dhe ujërave, procedurat e reagimit emergjent, sistemin e evidencave dhe monitorimit dhe planin e menaxhimit mjedisor, në mënyrë që të sigurohet operim i kontrolluar dhe i qëndrueshëm.

13. BURIMET E TË DHËNAVE

13.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- *Te dhënat nga investitori,*
- *<https://www.scribd.com/document/856412247/pzhk-obiliq#content=query:popullsia,pagenum:59,indexonpage:0,bestmatch:false>*
- *[Kosovo geoportal](#)*
- *[Obilić, 15000 to 42.6771815, 21.0590851 - google maps](#)*
- *[Ligji nr. 08/l-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis \(rks-gov.net\)](#)*
- *[Udhëzim administrativ nr. 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave](#)*
- *[Udhëzim administrativ \(mmphi\) nr:04 2025 për pëmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore , praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të](#)*